



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 106

Tiranë – E mërkurë, 18 qershor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 20, datë 5.6.2025	Për rregullat e hollësishme për prodhimin organik blegtoral, përfshirë rregullat për kalimin..... 14979
Urdhër i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët nr. 4, datë 13.6.2025	Për shpalljen e “Thirrjes së Dhjetë” në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës..... 15009
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 580, datë 10.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Greqisë..... 15009
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 581, datë 10.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Greqisë..... 15010
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 582, datë 10.6.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Letonisë.... 15012
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 584, datë 11.6.2025	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajes së ruminantëve të vegjël..... 15013
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 126, datë 12.6.2025	Autorizim i ndihmës shtetërore “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”..... 15014
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 225/9, datë 13.6.2025	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i bllokut të kufizuar nga rrugët ‘Ali Baushi’, ‘Arben Minga’, ‘Kongresi i Manastirit’, ‘Ibrahim Brahja’, ‘Xhanfize Keko’”.. 15016

Kërkesë e Agjencisë Shtetërore
për Shpronësimin nr. 457/10,
datë 12.6.2025

Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të
paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit
“Leje rikonstruksioni e ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo
ndryshim volumi, për projektin ‘Përforcimi i pallatit 1300’, Bashkia
Vlorë”.....



UDHËZIM

Nr. 20, datë 5.6.2025

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME
PËR PRODHIMIN ORGANIK
BLEGTORAL, PËRFSHIRË RREGULLAT
PËR KALIMIN¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për prodhimin organik për llojet e mëposhtme të kafshëve:

- a) gjedhët, përfshirë lopët, buajt dhe bizonët;
- b) njëthundrakët, përfshirë kuajt dhe gomarët;
- c) drerët;
- ç) derrat;
- d) të imëtat përfshirë delet dhe dhitë;
- dh) shpendët;
- e) lepujt;
- ë) bletë.

**Neni 2
Përkufizime**

1. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”.

2. Për efekt të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Gjel” është një shpend mashkull nga vezë të çelura, që përdoret për prodhimin e mishit;

b) “Kotec” është një ndërtesë fikse ose e lëvizshme për akomodimin e tufave të shpendëve, e cila përfshin të gjitha sipërfaqet e mbuluara me çati, përfshirë verandën. Koteci mund të ndahet në ndarje të veçanta, ku secila strehon një tufë të vetme;

c) “Ligj” është ligji nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”;

ç) “Lëndë e parë për ushqim për kafshë” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për etiketimin e ushqimit për kafshë;

d) “Ndarja fizike” është ndarja fizike ose ndarja në parcela toke të dallueshme gjeografikisht;

dh) “Ndarja financiare” është mbajtja e regjistrave të veçantë dhe faturave qartësisht të identifikueshme për secilën fermë;

e) “Ndarja operationale” është menaxhimi i fermave në mënyrë të dallueshme dhe të treguara në procedura dhe regjistrime të veçanta financiare dhe operationale;

ë) “Produkt mjekësor veterinar” ka kuptimin e dhënë në legjislacionin për shërbimin veterinar;

f) “Pula për vezë” janë kafshët e llojit *Gallus gallus*, që përdoren për prodhimin e vezëve për konsum dhe të moshës, të paktën 18-javëshe;

g) “Pulë” është shpend femër e racës *Gallus gallus* që përdoret për prodhimin e mishit dhe që theret pasi të ketë mbushur moshën të paktën 120 ditë;

gj) “Stallë” është një hapësirë e mbyllur që përfshin një pjesë në të cilën kafshëve i sigurohet mbrojtje nga kushtet e pafavorshme të motit;

h) “Shpendë për prodhim mish” janë shpendët që përdoren për prodhimin e mishit;

i) “Tufë” është një grup shpendësh që mbahen bashkë, në kontekstin e ndarjeve në kotece dhe në zona të brendshme dhe të jashtme të posaçme, por jo me lloje të tjera shpendësh;

j) “Trajtim veterinar” është trajtimi mjekësor ose parandalues kundër shfaqjes së një sëmundjeje të veçantë;

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (BE) nr. 2018/848, të datës 30 maj 2018, për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007 dhe rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2020/464, e datës 26 mars 2020, që përcakton rregulla për zbatimin e rregullores (BE) 2018/848 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me

dokumentet e nevojshme për njohjen prapavepruese të periudhës së kalimit, prodhimin e produkteve organike dhe informacionin që duhet paraqitet nga shtetet anëtare.

numri CELEX 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 150, datë 14.6.2018, faqe 1–92; numri CELEX 32020R0464, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 98, datë 31.3.2020, faqe 2–25.



k) “Veranda” është një pjesë shtesë, e mbuluar, e paizoluar, jashtë një ndërtese, që përdoret për shpendët, me anën më të gjatë zakonisht të pajisur me rrjetë teli ose rrjetë mbrojtëse, me klimë natyrale të jashtme dhe, kur është e nevojshme, ndriçim artificial, dhe dyshme të shtruar;

l) “Zonë e shfrytëzueshme” është një zonë me gjerësi të paktën 30 cm, me një pjerrësi dyshmeje që nuk e kalon 14%, dhe me lartësi të paktën 45 cm. Zonat për fole nuk konsiderohen zona të shfrytëzueshme;

ll) “Zogj pule” janë kafshët e reja të llojit *Gallus gallus*, të moshës më të vogël se 18-javëshe.”

Neni 3

Parimet lidhur me prodhimin organik blegtoral

1. Për prodhimin blegtoral zbatohen parimet lidhur me aktivitetet bujqësore, të përcaktuara në nenin 6 të ligjit.

2. Të gjitha kafshët në njësinë e prodhimit organik ose njësinë në kalim, pavarësisht statusit të tyre, menaxhohen në përputhje me rregullat për prodhimin organik, të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Në rastin e prodhimit organik bimor dhe blegtoral, ndalohet ruajtja e produkteve në njësinë prodhuese, përveç atyre që përdoren në prodhimin organik sipas përcaktimeve të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

KREU II

KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Neni 4

Ndarja e kafshëve organike nga kafshët e tjera

1. Kafshët joorganike, kafshët në kalim dhe kafshët organike mund të jenë të pranishme në fermë në të njëjtën kohë nëse ferma ndahet në njësi prodhimi të veçuara qartësisht dhe efektivisht, në përputhje me pikën 9 të nenit 9 të ligjit.

2. Kafshët joorganike mund të jenë të pranishme në fermë me kushtin që të rriten në njësi ku strehimet dhe parcelat ndahen në mënyrë të qartë nga njësitë e prodhimit organik, në përputhje me rregullat e prodhimit organik, duke përfshirë edhe lloje të ndryshme kafshësh.

3. Kur një operator menaxhon një fermë joorganike, krahas fermës organike ose në kalim, duhet të ketë ndarje fizike, financiare dhe operacionale ndërmjet këtyre fermave.

Neni 5

Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik

1. Në prodhimin organik blegtoral përdoren vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 21 të ligjit, si më poshtë:

a) lëndë vepruese në përmbajtje të produkteve për mbrojtjen e bimëve;

b) plehërues, përmirësues të tokës dhe lëndë ushqyese, në përmbajtje të produkteve plehëruese;

c) lëndë e parë për ushqime joorganike për kafshë, me origjinë bimore, shtazore, nga algat ose majatë apo si lëndë e parë për ushqime për kafshë, me origjinë mikrobike apo minerale;

d) produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, depozitave, kanaleve ujore, ndërtesave ose impianteve, që përdoren për prodhimin organik blegtoral;

e) produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe impianteve, që përdoren për prodhimin bimor, përfshirë ruajtjen në një fermë bujqësore;

f) produkte për pastrim dhe dezinfektim në stabilimentet e përpunimit dhe ruajtjes.

2. Në prodhimin organik përdoren si aditivë të ushqimit për kafshë dhe lëndë ndihmëse për përpunim, të përdorura për ushqyerjen e kafshëve, vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në pikën 3, të nenit 22 të ligjit.

Neni 6

Përshkrimi i njësisë së prodhimit

1. Përshkrimi i plotë i njësisë së prodhimit, të përcaktuar në shkronjën a, të pikës 2, të nenit 44 të ligjit, hartohet në përputhje me pikën 1, të nenit 12 të këtij udhëzimi.

2. Masat zbatuese, që përcaktohen në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 44 të ligjit, hartohen në përputhje me pikën 2, të nenit 12 të këtij udhëzimi.



Neni 7

Kullotja në tokë organike nga kafshët joorganike

1. Pa rënë ndesh me nenin 8 të këtij udhëzimi, kafshët organike kullojnë në tokë organike.

2. Kafshët joorganike mund të përdorin kullotat organike për një periudhë të kufizuar të çdo viti, në bazë të marrëveshjeve, me kushtin që të jenë rritur në mënyrë miqësore me mjedisin në kullota të mbështetura nga programi për zhvillimin rural dhe që të mos jenë të pranishme në të njëjtën kohë me kafshët organike në atë kullotë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 8 të këtij udhëzimi.

3. Kullotja e kafshëve joorganike në kullota organike ose në kalim i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) kullotja bëhet për qëllime të menaxhimit të kullotave ose të kontrollit të sëmundjeve;

b) periudha e kullotjes nuk i kalon 180 ditë për një vit kalendarik;

c) kafshët vijnë nga fermat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;

ç) kafshët organike nuk janë të pranishme në të njëjtën kohë në këtë kullotë;

d) respektohen periudhat e pezullimit për produktet mjekësore veterinarë, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij udhëzimi;

dh) kafshët trajtohen sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim, gjatë kullotjes në tokë organike ose në kalim;

e) këto kafshë dhe nënproduktet e tyre nuk shiten si organike;

ë) kafshët joorganike që kullojnë në tokë organike ose në kalim nuk ushqehen me ushqime për kafshë që përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht ose derivate të tyre ndërkohë që kullojnë në tokë organike;

f) ndërmjet prodhuesit organik dhe pronarit të kafshëve joorganike lidhet një marrëveshje kullotjeje, e cila përcakton kushtet për kullotjen në tokë organike.

Neni 8

Kullotja në tokë të përbashkët dhe shtegtimi i kafshëve

1. Kafshët organike mund të kullojnë në tokë të përbashkët me kafshët joorganike, me kushtin që:

a) toka e përbashkët të mos jetë trajtuar me produkte ose substanca që nuk përdoren në prodhimin organik, për të paktën 3 (tre) vjet;

b) kafshët joorganike që kullojnë në tokën e përbashkët, janë rritur në mënyrë miqësore me mjedisin në kullotën që mbështetet nga programi për zhvillimin rural;

c) produktet blegtorale nga kafshët organike, të cilat janë prodhuar gjatë periudhës kur ato kafshë kullojnë në tokë të përbashkët, nuk konsiderohen produkte organike, përveç rastit kur provohet ndarja e duhur nga kafshët joorganike.

2. Gjatë periudhës së shtegtitimit, kafshët organike mund të kullojnë në tokë joorganike kur ato zhvendosen nëpërmjet ecjes nga njëra zonë kullotjeje tek tjetra. Gjatë kësaj periudhe, kafshët organike mbahen të ndara nga kafshët e tjera. Marrja e ushqimit joorganik për kafshë, në formën e barit dhe bimëve të tjera me të cilat ushqehen kafshët, lejohet në këto raste:

a) maksimumi për 35 ditë, duke përfshirë rrugëtimin vajtje-ardhje; ose

b) maksimumi 10% e totalit të racionit ushqimor për kafshë në vit, llogaritur si përqindje e lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bujqësore.

3. Kur një operator kullot në tokë të përbashkët kafshë organike dhe/ose kafshë në kalim, që të pranohet në sistem certifikimi organik nga trupa e kontrollit, duhet të tregojë në kohën e inspektimit fillestar, që:

a) kafshët janë qartësisht të identifikueshme, të matricuara në përputhje me nenin 13 të këtij udhëzimi;

b) kafshët në sistem certifikimi organik nuk përzihen me kafshët joorganike të llojeve të njëjta, të tilla si tufa me bari ose tufa që qëndrojnë në zonën e tyre;

c) në tokën për kullotje nuk përdoren inpute të palejuara për prodhimin organik, e cila verifikohet nga të gjithë pronarët;

ç) çdo ushqim për kafshë shtesë, në të cilin kafshët organike mund të kenë akses është në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

d) deklarohen emrat e të gjithë pronarëve dhe statusi i njësisë nëse është konvencional, në kalim ose organik;

dh) të deklarohen normat e dendësisë së mbajtjes së kafshëve për sipërfaqen e tokës në fjalë.



Neni 9

Përpunimi dhe proceset e tjera

Nëse të kafshët kryhen procese të tjera përgatitje, të ndryshme nga përpunimi, zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 20 të ligjit, në të njëjtën mënyrë si për proceset e përpunimit, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta.

Neni 10

Shitja e kafshëve të gjalla

Shitja e kafshëve të gjalla, përveç zbatimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar duhet të dokumentohet dhe regjistrohet në përputhje me përcaktimet e nenit 21 të këtij udhëzimi.

KREU III

**KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR
MENAXHIMIN E KAFSHËVE ORGANIKE**

Neni 11

Praktikat e mbarështimit

1. Të gjithë personat e përfshirë në mbajtjen dhe menaxhimin e kafshëve gjatë transportit dhe therjes, duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme bazë në lidhje me shëndetin dhe nevojat për mirëqenien e kafshës dhe të kenë ndjekur trajnime të përshtatshme për të siguruar zbatimin e duhur të rregullave të parashikuara në ligj, këtë udhëzim dhe legjislacionin për shërbimin veterinar.

2. Praktikat e mbarështimit, përfshirë dendësinë e popullatës dhe kushtet e strehimit të kafshëve, sigurojnë përmbushjen e nevojave zhvillimore, fiziologjike dhe etologjike.

Neni 12

Plani i menaxhimit

1. Kur sistemi i kontrollit organik që lidhet specifikisht me prodhimin blegtoral, zbatohet për herë të parë, përshkrimi i plotë i njësisë së prodhimit organik ose në kalim, përfshin:

a) një përshkrim të plotë të ndërtesave që shërbejnë për mbajtjen e kafshëve, kullotës, zonave të hapura etj. Dhe kur është e mundur, të mjediseve për ruajtjen, ambalazhimin dhe përpunimin e produkteve blegtorale, lëndëve të para dhe inputeve;

b) një përshkrim të plotë të mjediseve për ruajtjen e plehut të kafshëve.

2. Masat dhe veprimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 44 të ligjit, përfshijnë:

a) një plan për shpërndarjen e plehut, të dakordësuar me autoritetin përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë, së bashku me një përshkrim të plotë të sipërfaqeve të përdorura për prodhimin e kulturave organike për ushqim për kafshë;

b) një marrëveshje me shkrim me ferma të tjera organike që, për shpërndarjen e plehut, veprojnë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për prodhimin organik;

c) një plan menaxhimi për njësinë e prodhimit organik blegtoral;

ç) shpërndarjen e tepicës së plehut organik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 10, të nenit 13 të ligjit.

3. Plani i menaxhimit të kafshëve, që referohet në shkronjën “c”, të pikës 2 të këtij neni, hartohet dhe dakordësohet me trupën e kontrollit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 20, të këtij udhëzimi.

4. Kafshët duhet të kenë akses për të pirë ujë gjatë gjithë kohës dhe cilësia e ujit të pijshëm kontrollohet rregullisht.

Neni 13

Identifikimi i kafshëve

Kafshët identifikohen në mënyrë të përhershme, duke përdorur teknika të përshtatura për çdo lloj, individualisht në rastin e gjitarëve të mëdhenj dhe individualisht ose në tufë në rastin e shpendëve dhe gjitarëve të vegjël, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin veterinar.

Neni 14

Aksesi në zona të hapura

1. Kafshët kanë akses të përhershëm në zona të hapura që i lejojnë kafshët të kullotin dhe të lëvizin të lira, në varësi nga kushtet sezonale, të motit dhe gjendja e terrenit, përveç rasteve kur vendosen kufizime dhe detyrime në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, në bazë të legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar.



2. Zonat e hapura mund të jenë pjesërisht të mbuluara. Verandat nuk konsiderohen zona të hapura.

3. Me përjashtim të kafshëve të llojit derra, shpendëve dhe bletëve, kafshët e tjera kanë akses të përhershëm në kullota kur e lejojnë kushtet ose në ushqime me fibra bimore.

4. Zonat e kullotjes në gjendje të lirë, të ushtrimit ose vrapimit në natyrë, ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme ndaj shiut, erës, diellit dhe temperaturave ekstreme, në varësi të kushteve lokale të motit dhe racës përkatëse. Mbajtja jashtë në dimër e kafshëve është e pranueshme kur kushtet e lejojnë një gjë të tillë, me kusht që racat të jenë rezistente ndaj kushteve të vështira klimatike dhe/ose kur ka strehim të përshtatshëm për të parandaluar ndonjë problem lidhur me mirëqenien e tyre.

5. Me përjashtim të parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, akses i përhershëm në zona të hapura në natyrë gjatë muajve të dimrit mund të kufizohet, me kusht që gjedhët, njëhundrakët, të imëtat dhe drerët të kenë akses në kullota gjatë periudhës së kullotjes dhe sistemi i strehimit dimëror i lejon kafshët të lëvizin lirshëm.

Neni 15

Dendësia e popullatës së kafshëve

1. Numri i kafshëve kufizohet me qëllim që të minimizohet kullotja e tepërt, shkelja e tokës, erozioni dhe ndotja e shkaktuar nga kafshët ose nga përhapja e plehut të tyre.

2. Dendësia e popullatës së kafshëve në mjedise të jashtme që mbahen në kullota, terren me barishte, ligatina, barishte dhe habitate të tjera natyrore ose gjysmënatyrore duhet të jetë e ulët mjaftueshëm për të parandaluar shkeljen e tokës dhe kullotjen e tepërt me bimësi.

3. Dendësia e përgjithshme e popullatës së kafshëve nuk kalon kufirin prej 170 kg azot për hektar toke bujqësore në vit.

Neni 16

Veprimet përjashtimore që kryhen te kafshët

1. Çdo vuajtje, dhimbje dhe shqetësim duhet të shmanget dhe të mbahet në minimumin e mundshëm gjatë gjithë jetës së kafshës, përfshirë edhe kohën e therjes.

2. Prerja e pjesshme e bishtit të deles, prerja e pjesës së sipërme të sqepit të shpendëve që bëhet në tre ditët e para të jetës, dhe heqja e brirëve lejohen në raste përjashtimore, individuale dhe vetëm nëse këto praktika përmirësojnë shëndetin, mirëqenien ose higjienën e kafshëve, ose në rastet kur cenohet siguria e punonjësve. Heqja e nyjës së bririt lejohet vetëm për raste individuale dhe kur përmirëson shëndetin, mirëqenien ose higjienën e kafshëve, ose në rastet kur cenohet siguria e punonjësve.

3. Çdo vuajtje te kafshët reduktohet në minimum, duke përdorur anestezi dhe/ose analgjezi të përshtatshme, duke kryer këto veprime në moshën më të përshtatshme të kafshëve, dhe nga personel i kualifikuar.

4. Kastrimi fizik lejohet në raste përjashtimore, për të ruajtur cilësinë e produkteve blegtorale dhe praktikatat tradicionale të prodhimit të tyre, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

5. Operatorët mbajnë të dhëna për procedurat e parashikuara në pikat 2 dhe 4, të këtij neni, në përputhje me pikën 2, të nenit 75 të këtij udhëzimi.

6. Përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve përjashtimore të përcaktuara në pikat 2 dhe 4, të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania*, në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

7. Autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimet e përcaktuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, kur operatori ka arsyetuar nevojën për këto veprime, të cilat kryhen nga personel i kualifikuar.

Neni 17

Pastrimi dhe dezinfektimi

1. Mjediset e strehimit, stallat, pajisjet dhe enët pastrohen dhe dezinfektohen në mënyrë që të parandalohen infeksionet e kryqëzuara dhe grumbullimi i organizmave që mbartin sëmundje. Fekalet, urina dhe ushqimi i pakonsumuar ose i ndarë largohet sa më shpesh të jetë e nevojshme, për të minimizuar erën e keqe dhe për të shmangur tërheqjen e insekteve ose brejtësve.

2. Për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe instalimeve blegtorale, përdoren vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 21 të ligjit.

3. Në ndërtesa dhe instalime të tjera ku mbahen kafshët për eliminimin e insekteve dhe dëmtuesve të tjerë, përdoren vetëm produktet dhe substancat e



përcaktuara në pikën 4, të nenit 21 të ligjit. Rodenticidet (substancat vrasëse të brejtësve) përdoren vetëm në çarqe.

4. Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e këtyre produkteve, në përputhje me nenin 81 të këtij udhëzimi.

Neni 18

Trajtimi dhe transportimi i kafshëve të gjalla

1. Kohëzgjatja e transportit të kafshëve të jetë në minimum për të siguruar mirëqenien e tyre.

2. Çdo vuajtje, dhimbje dhe shqetësim duhet të shmanget dhe të mbahet në minimumin e mundshëm gjatë gjithë jetës së kafshës, përfshirë edhe kohën e therjes, siç përcaktohet dhe në pikën 1, të nenit 16 të këtij udhëzimi.

3. Ngarkimi dhe shkarkimi i kafshëve kryhet pa përdorur asnjë lloj stimulimi elektrik ose stimulim tjetër të dhimbshëm për kafshët. Përpara ose gjatë transportit ndalohet përdorimi i qetësuesve alopatikë.

4. Operatorët mbajnë regjistrime dhe të dhëna të dokumentuara për kafshët që largohen nga ferma, në përputhje me pikën 1, të nenit 76 të këtij udhëzimi.

5. Gjatë transportit, kafshët trajtohen me kujdesin dhe interesimin e duhur për mirëqenien e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar.

6. Gjatë përgatitjes së ngarkesave, ngarkimit të mjeteve, gjatë tranzitit dhe në shkarkim, kafshët trajtohen në kushte të tilla që minimizojnë stresin dhe shmangin gjasat për lëndime dhe sigurohet që:

a) veprimet kryhen në mënyrë të qetë dhe nga personel me përvojë;

b) shmanget përzjerja e kafshëve me lloje të tjera;

c) shmanget përdorimi i forcës së panevojshme fizike mbi kafshët;

ç) në pikat e ngarkimit dhe shkarkimit ka dhe mirëmbahen mjedise të përshtatshme trajtimi;

d) mjetet e transportit ajrosen gjatë gjithë udhëtimit.

7. Mjetet e transportit që përdoren për transportimin e kafshëve janë të përshtatshme, dhe mbahen në kushte të mira higjienike. Përveç rasteve kur kafshët transportohen në ngarkesa të njëpasnjëshme brenda fermës, mjetet e transportit pastrohen dhe dezinfektohen pas çdo ngarkese.

8. Gjatë transportit, mjetet drejtohen me kujdes, duke shmangur shpejtësinë e lartë, nisjen ose ndalimin e menjëhershëm, ose marrjen me shpejtësi të kthesave, për të shmangur dëmtimet ose lëndimet e kafshëve.

KREU IV

REGJISTRI I KAFSHËVE

Neni 19

Regjistrimet dhe dokumentacioni përkatës

1. Të dhënat e kafshëve mbahen në formën e një regjistri në mjediset e fermës, dhe janë të disponueshme gjatë gjithë kohës për trupën e kontrollit dhe autoritetin përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun XVI të këtij udhëzimi.

2. Regjistri i të dhënave, përmban informacionin e mëposhtëm në lidhje me:

a) planin e menaxhimit të kafshëve, siç përcaktohet në nenin 20 të këtij udhëzimi;

b) lëvizjen e kafshëve, siç përcaktohet në nenin 21 të këtij udhëzimi;

c) kullotjen, siç përcaktohet në nenin 22 të këtij udhëzimi;

ç) ushqimin për kafshë, siç përcaktohet në nenin 23 të këtij udhëzimi;

d) planin e monitorimit të shëndetit të kafshës, siç përcaktohet në nenin 24 të këtij udhëzimi;

dh) trajtimet veterinare, siç përcaktohet në nenin 25 të këtij udhëzimi;

e) përjashtimet e miratuara në përputhje me pikat 2 dhe 4, të nenit 16, pikën 2, të nenit 27, pikën 11, të nenit 34, shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 54, pikën 1, të nenit 57, pikën 4, të nenit 58, dhe shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 59, të këtij udhëzimi.

Neni 20

Plani i menaxhimit të kafshëve

Plani i menaxhimit të kafshëve, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 19 të këtij udhëzimi, hartohet dhe mbahet nga operatori dhe përfshin rregulla në lidhje me:

a) ndarjen e kafshëve organike e joorganike dhe masat praktike për mbajtjen e ndarjes fizike, financiare dhe operacionale, në përputhje me nenin 4 të këtij udhëzimi;



b) programin për periudhën e kalimit të kafshëve nga joorganike në organike;

c) menaxhimin e përgjithshëm dhe mirëqenien e kafshëve që përfshin shëndetin e kafshëve, aksesin në hapësira të jashtme, transportin dhe therjen, strehimin, ruajtjen dhe trajtimin e plehut të kafshëve, si dhe ushqyerjen, përfshirë ruajtjen e ushqimit për kafshë;

ç) veprimet që kryhen te kafshët;

d) strehimin;

dh) ushqimin për kafshë.

Neni 21

Informacioni për lëvizjen e kafshëve

Informacioni për lëvizjen e kafshëve, siç përcaktohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 19, të këtij udhëzimi, përmban një përshkrim të plotë të sistemit të menaxhimit të kopësë ose tufës, duke përfshirë të paktën informacionet e mëposhtme në lidhje me:

a) kafshët e lindura në fermë;

b) kafshët që hyjnë në fermë;

i. origjinën;

ii. llojet, identifikimin, numrin dhe moshën;

iii. datën e mbërritjes në fermë;

iv. certifikatën e operatorit organik që furnizon me kafshë, për të verifikuar datën e kalimit në organik për operatorët që kanë më pak se tre vjet në sistemin e kontrollit;

v. statusin nëse është konvencional, në kalim ose organik dhe datën kur mund të arrihet statusi organik;

vi. historikun e trajtimit veterinar dhe masat e marra për karantinën;

c) kafshët që largohen nga ferma ose humbin:

i. llojet, numrin e krerëve dhe moshën;

ii. identifikimin;

iii. statusin e certifikimit në kalim ose organik;

iv. destinacionin, emrin dhe adresën;

v. peshën në rast therjeje;

vi. detajet për rastet e humbjes së kafshëve dhe arsytet.

Neni 22

Informacioni për kullotjen

Informacioni për kullotjen, siç përcaktohet në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 19 të këtij udhëzimi, përmban detaje të hollësishme, të paktën

për kullotjen e përbashkët dhe shtegtimin, në përputhje me nenin 8 të këtij udhëzimi.

Neni 23

Informacioni për ushqimin për kafshë

Informacioni për ushqimin për kafshë, siç përcaktohet në shkronjën “d”, të pikës 2, të nenit 19 të këtij udhëzimi, përmban një përshkrim të plotë të sistemit të menaxhimit të kopësë ose tufës, duke përfshirë të paktën ushqimin për kafshë, për secilin lloj të kafshës si:

a) llojin e ushqimit për kafshë, përfshirë suplementet ushqimore;

b) raportet e përbërësve të ndryshëm të racioneve, qofshin organike, në kalim ose joorganike, në bazë të lëndës së thatë;

c) periudhat e aksesit në mjediset ku kafsha lihet në gjendje të lirë;

ç) periudhat e shtegimit, kur zbatohen kufizime;

d) burimet e të gjithë përbërësve, përfshirë ushqimet për kafshë të sjella nga jashtë fermës dhe ato të rritura në fermë;

dh) burimin dhe përbërjen e ushqimeve të kombinuara për kafshë;

e) deklaratën që nuk janë OMGJ për ushqimet joorganike për kafshë me një përbërës, që përdoret për ushqyerjen e derrave dhe shpendëve.

Neni 24

Plani i monitorimit të shëndetit të kafshës

1. Plani i shëndetit, siç përcaktohet në shkronjën “e”, të pikës 2, të nenit 19 të këtij udhëzimi, hartohet dhe mbahet nga operatori, me mbështetjen e veterinerit privat, të njohur nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar, për të përmbushur kërkesat për shëndetin e kafshëve dhe trajtimet veterinare.

2. Plani përmban një strategji për përmirësimin e shëndetit dhe masat për kontrollin e sëmundjeve, në përputhje me rrethanat e veçanta të fermës dhe krijon kushtet për zhvillimin e një sistemi blegtoral sa më pak të varur nga produktet alopatike mjekësore veterinare.

Neni 25

Informacioni për trajtimin veterinar

Informacioni për trajtimin veterinar, siç përcaktohet në shkronjën “f”, të pikës 2 të nenit 19,



të këtij udhëzimi, përfshin informacion për parandalimin e sëmundjeve, trajtimin dhe kujdesin veterinar si:

- a) identiteti i kafshëve të trajtuara;
- b) numri i kafshëve të trajtuara;
- c) datat e fillimit dhe përfundimit të trajtimit;
- ç) përshkrime të hollësishme për diagnozën;
- d) emri i produktit veterinar të përdorur dhe lloji i trajtimit;
- dh) përfshirjen e substancave farmakologjike aktive;
- e) metodat e trajtimit dhe receta veterinare për trajtim veterinar së bashku me arsyet;
- ë) emri i personit që ka administruar produktin veterinar;
- f) periodha e detyrueshme e pezullimit që zbatohet përpara se produkti blegtoral organik të tregtohet me etiketimin si organik dhe data më e afërt për shitjen e kafshës ose produkteve.

KREU V ORIGJINA E KAFSHËVE

Neni 26 Kafshët organike

1. Pa rënë ndesh me rregullat për kalimin, kafshët organike lindin/çelin dhe rriten në njësitë e prodhimit organik.

2. Për sa i përket mbarështimit të kafshëve organike:

- a) riprodhimi bëhet me mënyra natyrale, por lejohet edhe inseminimi artificial;
- b) riprodhimi nuk nxitet ose pengohet me anë të trajtimit me hormone ose lëndë të tjera me efekte të ngjashme, përveçse si formë e trajtimit terapeutik veterinar, në rastin e një kafshë individuale;
- c) format e tjera të riprodhimit artificial, si klonimi dhe transferimi i embrioneve, nuk përdoren;
- ç) zgjedhja e racave bëhet sipas parimeve të prodhimit organik, garanton një standard të lartë të mirëqenies së kafshës dhe kontribuon për parandalimin e vuajtjes dhe shmangien e nevojës së manipulimit të kafshëve.

3. Në zgjedhjen e racave ose llojeve, pa dëmtuar mirëqenien e kafshëve, operatorët i japin përparësi racave ose llojeve:

- a) me shkallë më të lartë diversiteti gjenetik;
- b) aftësi për t'u përshtatur me kushtet lokale;
- c) mbarështimi,

ç) gjallëri dhe rezistencë ndaj sëmundjeve ose problemeve shëndetësore.

Racat ose llojet e kafshëve zgjidhen me qëllim shmangien e sëmundjeve ose problemeve shëndetësore të veçanta, që lidhen me disa raca ose lloje të përdorura në prodhimin intensiv, si sindroma e stresit të derrat, që ka gjasa të rezultojë me mish të çngjyrosur, të butë e me rrjedhje lëngjesh, ngordhje të papritur, abort spontan dhe lindje të vështira që kërkojnë ndërhyrje cezariene. Përparësi i jepet racave dhe llojeve autoktone.

4. Me qëllim zgjedhjen e racave dhe llojeve, operatorët përdorin informacionin që gjendet në sistemin e përcaktuar në nenin 24 të ligjit.

Neni 27 Kafshët joorganike

1. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 26, të këtij udhëzimi, për qëllime mbarështimi, kafshët e rritura në mënyrë joorganike futen në njësinë e prodhimit organik në përputhje me programet për zhvillimin rural, kur racat rrezikojnë të zhduken. Në këto raste, kafshët nuk duhet të jenë domosdoshmërisht nulipare.

2. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 26 të këtij udhëzimi, kur të dhënat në sistemin e përcaktuar në nenin 24 të ligjit, tregojnë se nuk plotësohen nevojat cilësore ose sasiore të operatorit për kafshë organike, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimin për hyrjen e kafshëve joorganike në njësinë e prodhimit organik, nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni. Përpara se të kërkohej një përjashtim i tillë, operatori verifikon që kafshët nuk përfshihen në listën e përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 24 të ligjit.

3. Për qëllime të mbarështimit, kafshët joorganike të reja në moshë, hyjnë në njësinë e prodhimit organik kur tufa ose kopeja e këtij lloji krijohet për herë të parë. Këto kafshë rriten në përputhje me rregullat e prodhimit organik blegtoral, menjëherë pas shkëputjes nga ushqyerja me qumështin e nënës.

Në datën e hyrjes së këtyre kafshëve në kope apo tufë, zbatohen kufizimet e mëposhtme:

- a) gjedhët, njëhundrakët dhe drerët duhet të jenë të moshës më pak se 6 muajsh;
- b) dhentë dhe dhitë duhet të jenë të moshës më pak se 60-ditëshe;



c) derrat duhet të peshojnë më pak se 35 kg;
ç) lepujt duhet të jenë të moshës më pak se 3 muajsh.

4. Për qëllime mbarështimi dhe të ripërtëritjes së një kopeje apo tufe, në njësinë e prodhimit organik hyjnë kafshë joorganike në moshë të rritur, meshkuj, dhe kafshë gjitare femra nulipare, që më pas rriten sipas rregullave të prodhimit organik blegtoral.

Numri i kafshëve gjitare femra nulipare, që hyjnë në njësinë e prodhimit organik, i nënshtrohet këtyre kufizimeve vjetore:

a) maksimumi deri në 10% të kafshëve në moshë të rritur, të llojeve njëthundrakë ose gjedhë dhe 20% e kafshëve të rritura të llojeve derra, dhen, lepuj ose drerë;

b) për njësitë me më pak se 10 kafshë të llojeve njëthundrakë, drerë, gjedhë ose lepuj, ose me më pak se 5 kafshë të llojeve derra, dhen ose dhi, çdo ripërtëritje e tillë kufizohet maksimumi në 1 kafshë në vit.

5. Përqindjet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni mund të rriten deri në 40%, me kusht që autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë të konfirmojë përmbushjen e një prej kushteve të mëposhtme:

- a) ka ndodhur një zgjerim i madh në fermë;
- b) kur një racë është zëvendësuar me një tjetër;
- c) ka ndryshuar drejtimi i prodhimit të kafshëve në fermë, si nga për qumësht në mish.

6. Në rastet e përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni, kafshët joorganike konsiderohen organike vetëm nëse është respektuar periudha e kalimit, e përcaktuar në nenet 28 dhe 29 të këtij udhëzimi. Periudha e kalimit fillon me hyrjen e kafshëve në njësinë e prodhimit në kalim.

7. Në rastet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, kafshët joorganike mbahen të ndara ose identifikuar nga pjesa tjetër e kafshëve, deri në përfundim të periudhës së kalimit, të përcaktuar në pikën 6 të këtij neni.

8. Për miratimin e përjashtimeve për hyrjen e kafshëve joorganike në njësinë e prodhimit organik, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet formateve të miratuara në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

9. Operatorët mbajnë regjistra, të dhëna dhe dokumentacionin për origjinën e kafshëve, duke i identifikuar sipas sistemeve të përshtatshme për çdo kafshë individualisht, ose sipas grupit /tufës/

koshereve, për të dhënat veterinarë të kafshëve të futura në fermë, datën e mbërritjes dhe periudhën e kalimit.

KREU VI PERIUDHA E KALIMIT

Neni 28

Fillimi i njëkohshëm i periudhës së kalimit të tokës dhe kafshës

1. Në rastet e fillimit të njëkohshëm të periudhës së kalimit të gjithë njësisë së prodhimit blegtoral, përfshirë kullotat ose tokën e përdorur për ushqim për kafshët, dhe të kafshëve të pranishme në këtë njësi prodhimi në fillim të periudhës së kalimit të kësaj njësie prodhimi, sipas përcaktimeve të pikës 10, të nenit 13 të ligjit, kafshët dhe produktet me origjinë shtazore konsiderohen organike në fund të periudhës së kalimit të njësisë së prodhimit, edhe nëse periudha e kalimit për llojin e kafshës në fjalë është më e gjatë se periudha e kalimit për njësinë e prodhimit.

2. Në përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 38 të këtij udhëzimi, në rastet e kalimit të njëkohshëm dhe gjatë periudhës së kalimit të njësisë së prodhimit, kafshët e pranishme në fillim të periudhës së kalimit të njësisë së prodhimit, mund të ushqehen me ushqim për kafshë në kalim, të prodhuar në njësinë e prodhimit në kalim gjatë vitit të parë të kalimit dhe/ose me ushqim për kafshë organike.

3. Kafshët joorganike, në varësi të llojit, mund të futen në një njësi prodhimi në kalim, pas fillimit të periudhës së kalimit, në përputhje me nenin 27 të këtij udhëzimi.

Neni 29

Periudhat e kalimit për kafshën joorganike që hyn pas fillimit të kalimit të njësisë së prodhimit

Periudhat e veçanta të kalimit, për llojet e prodhimit blegtoral, janë si më poshtë:

a) dymbëdhjetë muaj në rastin e kafshëve të llojit gjedhë dhe njëthundrakë për prodhim mishi, dhe në çdo rast jo më pak se tre të katërtat e jetës së tyre;

b) gjashtë muaj në rastin e kafshëve të llojit gjedhë, dhen dhe derra dhe kafshëve për prodhim qumështi;



c) dhjetë javë për shpendët për prodhim mishi, me përjashtim të rosave të racës pekineze, të sjella para moshës treditëshe;

ç) shtatë javë për rosat e racës pekineze, të sjella para moshës treditëshe;

d) gjashtë javë në rastin e shpendëve për prodhimin e vezëve, të sjella para moshës treditëshe;

dh) dymbëdhjetë muaj për bletët. Gjatë periudhës së kalimit, dylli zëvendësohet me dyllë të ardhur nga bletaria organike. Megjithatë, mund të përdoret dylli joorganik i bletës në rastet:

i. kur dylli i bletës nga bletaria organike nuk gjendet në treg;

ii. kur vërtetohet se nuk ka kontaminim me produkte ose substanca që nuk përdoren në prodhimin organik dhe;

iii. me kusht që të vijë nga kapaku i zgjoit;

e) tre muaj për lepujt;

ë) dymbëdhjetë muaj për drerët.

Neni 30

Rregullat e kalimit

Rregullat e kalimit të përcaktuara në pikën 10, të nenit 13 të ligjit, zbatohen në të gjithë njësinë e prodhimit të ushqimit për kafshët që përfshihet në njësinë e prodhimit organik blegtoral.

Neni 31

Kushtet për kalimin e njëkohshëm të tokës dhe kafshës

Kalimi i njëkohshëm, siç përcaktohet në nenin 28 të këtij udhëzimi, i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) zbatohet për të gjitha kafshët në njësinë që është në kalim të njëkohshëm, nga fillimi i periudhës së kalimit, përveç kur, si pjesë e planit të kalimit, kafshët joorganike të mbetura qëndrojnë në fermë për një periudhë të kufizuar;

b) kafshët ushqehen me produkte nga njësia e prodhimit;

c) kafshët që plotësojnë tërësisht kërkesat e ligjit dhe këtij udhëzimi sillen në njësi ose shiten nga njësia, por këto kafshë dhe çdo produkt i tyre nuk shitet si organik deri në përfundimin e periudhës 24-mujore të kalimit të njëkohshëm të njësisë;

ç) në përjashtim nga shkronja “c” të këtij neni, qumështi i prodhuar nga kafshët, shitet si organik pas 6 muajsh që kafsha ndodhet në njësinë plotësisht

organike ose në fund të periudhës 24-mujore të kalimit të njësisë nga ka ardhur, cilido afat arrihet i pari.

Neni 32

Kafshët që nuk i nënshtrohen kalimit të njëkohshëm me tokën

1. Kafshët ekzistuese që nuk i nënshtrohen kalimit të njëkohshëm me tokën identifikohen në planin e menaxhimit për njësinë e prodhimit organik blegtoral. Kjo vlen për të gjitha kafshët që ndodhen në fermë që në fillim të periudhës së kalimit.

2. Kafshët në njësinë në kalim nuk i nënshtrohen kërkesave të këtij udhëzimi derisa të fillojë periudha e kalimit të tyre, me përjashtim të kërkesës që ushqimi për kafshë të mos përmbajë OMGJ ose të jetë prodhuar nga OMGJ.

3. Të gjitha kafshët në njësi fillojnë periudhën e kalimit të tyre jo më vonë se fundi i periudhës së kalimit për tokën, përveç kur në planin e menaxhimit/kalimit përcaktohet se njësia e prodhimit nuk i nënshtrohet kalimit, dakordësuar edhe me trupën e kontrollit.

4. Asnjë kafshë ose produkt me origjinë shtazore nuk shitet si organik derisa toka të ketë arritur statusin organik dhe të jetë plotësuar periudha e kalimit, e përcaktuar në nenin 29 të këtij udhëzimi.

Neni 33

Reduktimi i periudhës së kalimit për zonat ku kullotin jobarngrënësit

Pavarësisht rregullave të nenit 30 të këtij udhëzimi, periudha e kalimit mund të reduktohet në një vit për kullotat dhe zonat në natyrë që përdoren nga llojet e kafshëve jobarngrënëse si pulat, derrat etj.

KREU VII STREHIMI

Neni 34

Rregulla të përgjithshme

1. Dendësia e mbajtjes së kafshëve dhe kushtet e strehimit sigurojnë përmbushjen e nevojave zhvillimore, fiziologjike dhe etologjike të kafshëve, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 11, të këtij udhëzimi.



2. Izolimi, ngrohja dhe ventilimi i ndërtesave siguron që qarkullimi i ajrit, sasia e pluhurit, temperatura, lagështia relative e ajrit dhe përqendrimi i gazit të mbahen në kufij që garantojnë mirëqenien e kafshëve. Ndërtesa duhet të ketë ajrim dhe dritë të bollshme natyrale.

3. Strehimi i kafshëve nuk është i detyrueshëm në zonat me kushtet e përshtatshme klimatike, që lejojnë që kafshët të jetojnë në mjedise të hapura. Në këto raste, kafshët duhet të kenë akses në streha ose vende me hije, për t'u mbrojtur nga kushtet e vështira të motit.

4. Dendësia e mbajtjes së kafshëve në ndërtesa siguron rehatinë, mirëqenien dhe nevojat e veçanta sipas llojit, racës dhe moshës së kafshëve. Gjithashtu, merret në konsideratë edhe sjellja së kafshëve, e cila varet veçanërisht nga përmasat e grupit dhe gjinia e kafshëve. Dendësia siguron mirëqenien e kafshëve duke ofruar hapësirë të mjaftueshme për të qëndruar lirshëm, për të lëvizur dhe për t'u shtrirë lehtësisht, për t'u kthyer, për t'u kujdesur e pastruar veten, për të marrë të gjitha pozicionet natyrale dhe për të bërë të gjitha lëvizjet natyrale, si shtriqja apo rrahja e krahëve.

5. Të respektohet sipërfaqja minimale për mjediset e brendshme dhe të jashtme, dhe kushtet teknike lidhur me strehimin e kafshëve. Kushtet teknike të veçanta për çdo lloj kafshe, përcaktohen në krerët X–XV të këtij udhëzimi.

6. Materialet e ndërtimit, që janë trajtuar me bojëra ose konservantë toksikë për kafshët, nuk duhet të jenë në kontakt me kafshët.

7. Përdorimi i objekteve për strehimin dhe trajtimin e kafshëve jashtë fermës, nga një njësi e prodhimit blegtoral konvencional, miratohet paraprakisht nga trupa e kontrollit. Kontrata për përdorim është për një periudhë minimalisht pesëvjeçare.

8. Kafazet, bokset dhe padoqet nuk përdoren për rritjen e asnjë lloji kafshe.

9. Kur kafsha trajtohet individualisht për arsye veterinare, ajo mbahet në hapësirë me dyshe me solide të shtruar me kashtë ose shtrijë të përshtatshme. Kafsha duhet të ketë mundësi të kthehet me lehtësi dhe të shtrihet në pozicion të rehatshëm, në të gjithë gjatësinë.

10. Kafsha organike nuk rritet në vatha me tokë shumë të lagësht ose moçalore.

11. Ndalohet lidhja ose izolimi i kafshëve, me përjashtim të kafshëve individuale, për një periudhë

të kufizuar dhe për arsye veterinare. Ky përjashtim miratohet vetëm për një periudhë të kufizuar, kur cenohet shëndeti i punonjësve ose mirëqenia e kafshëve. Autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimin për lidhjen e gjedhëve, në ferma me numër maksimal 50 kafshë, pa përfshirë të vegjlit në moshë, kur nuk mund të mbahen në grupe në përshtatje me kërkesat e sjelljeve të tyre, por me kusht që të kenë akses, të paktën dy herë në javë, në kullota gjatë periudhës së kullotjes dhe në mjedise të hapura kur kullotja nuk është e mundur.

12. Nëse nuk është e mundur që gjedhët të mbahen në grupe të përshtatshme me kërkesat e sjelljeve të tyre, në përputhje me pikën 11 të këtij neni, operatori aplikon për miratimin e këtij përjashtimi në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet formateve të miratuara në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

KREU VIII USHQYERJA

Neni 35

Kërkesat e përgjithshme të ushqyerjes së kafshëve

1. Kafshët ushqehen me ushqime për kafshë, organike ose në kalim, që plotësojnë kërkesat për ushqyerjen e kafshëve, në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Në prodhimin blegtoral nuk lejohet ushqyerja e kufizuar, përveç se për arsye veterinare.

2. Me përjashtim të kafshëve të llojit derra, shpendëve dhe bletëve, kafshët kanë akses të përhershëm në kullota ose ushqime me fibra bimore.

3. Çdo përbërës ushqimor për kafshë që përdoret ose përpunohet në prodhimin organik, nuk duhet të jetë i përpunuar me ndihmën e tretësve të sintetizuar kimikisht.

4. Nuk përdoren nxitës për rritje dhe aminoacide sintetike.

5. Sistemet e rritjes për kafshët barngrënëse bazohen në përdorimin maksimal të kullotës, sipas disponueshmërisë së kullotave në periudha të ndryshme të vitit;

6. Kafshët nuk mbahen në kushte ose dietë që mund të nxisë aneminë;



7. Praktikrat e majmërisë respektojnë modelet e ushqyerjes normale për secilën prej llojeve të kafshëve dhe mirëqenien e kafshëve në çdo fazë të rritjes. Ushqyerja e detyruar është e ndaluar.

Neni 36

Qumështi i nënës

1. Kafshët e sapolindura që pinë qumësht gjiri, ushqehen me qumështin e nënës, për të paktën:

a) 90 ditë pas lindjes për gjedhët dhe njëthundrakët;

b) 45 ditë pas lindjes për dhentë dhe dhitë;

c) 90 ditë pas lindjes, për drerët;

ç) 40 ditë pas lindjes, për gicat;

d) 42 ditë pas lindjes, për lepujt.

2. Zëvendësuesit e qumështit që kanë përbërës të sintetizuar kimikisht ose përbërës me origjinë bimore nuk përdoren gjatë periudhës minimale të ushqyerjes me gjë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rastet kur qumështi i nënës nuk gjendet, përdoret kullloshtër organike.

Neni 37

Ushqimi për kafshë nga vetë ferma ose nga ferma të tjera organike

Ushqimi për kafshë sigurohet kryesisht nga vetë ferma e prodhimit blegtoral ose nga njësi organike ose në kalim nga ferma të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 38

Përdorimi i ushqimit për kafshë në kalim

1. Mesatarisht, deri në 25% e racioneve të formulës së ushqimit për kafshët, mund të përmbajë ushqim për kafshë në vitin e dytë në kalim. Kjo përqindje mund të rritet deri në 100% nëse ushqimi për kafshët në kalim vjen nga vetë ferma ku mbahen këto kafshë.

2. Deri në 20% e sasisë së përgjithshme mesatare të ushqimit për kafshë mund të ketë origjinë nga kullotja në kullota të përhershme ose nga korrrja e tyre, parcela shumëvjeçare foragjere ose kultura bujqësore proteinike, të mbjella në toka që janë në vitin e parë në kalim, me kusht që këto toka të jenë pjesë e fermës në fjalë.

3. Kur përdoren të dy llojet e ushqimit për kafshë në kalim, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përqindja totale e kombinuar e këtij ushqimi për kafshë, nuk duhet të kalojë përqindjen e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Përqindjet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përllogariten mbi bazë vjetore, si përqindje e lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bimore.

Neni 39

Përdorimi i ushqimit për kafshë, joorganik

Lëndët e para për ushqim për kafshë joorganik, me origjinë bimore, nga algat, shtazore, ose majatë, lëndët e para për ushqim për kafshë, me origjinë mikrobike ose minerale, aditivët e ushqimit për kafshë dhe lëndët ndihmëse për përpunim, përdoren vetëm nëse janë miratuar, në përputhje me pikën 3 të nenin 22 të ligjit.

Neni 40

Produktet dhe substancat që përdoren në ushqimin për kafshë

1. Lëndët e para të ushqimit për kafshë, me origjinë bimore, nga algat, me origjinë shtazore ose majatë duhet të jenë organike.

2. Në prodhimin organik, përdoren vetëm lëndët e para joorganike për ushqim për kafshë me origjinë bimore, nga algat, me origjinë shtazore, majatë, me origjinë mikrobike ose minerale, dhe aditivët e ushqimit për kafshë dhe lëndët ndihmëse për përpunim, të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, dhe pikën 3, të nenit 22 të ligjit.

3. Në planin e shëndetit dhe mirëqenies identifikohen mungesat e mineraleve dhe arsytet për trajtimet veterinarë, së bashku me planifikimin për reduktimin e përdorimit tyre, kur është e mundur.

4. Lejohet përdorimi i lëpirësive minerale të pastra, pa aditivë. Lëpirëset minerale që përmbajnë melasë, mund të përdoren me miratimin paraprak të trupës së kontrollit.

5. Ushqimet për kafshë, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nuk përmbajnë OMGJ, sipas etiketës ose dokumenteve të tjera shoqëruese të ushqimit për kafshë.



KREU IX
SHËNDETI I KAFSHËVE DHE
TRAJTIMET VETERINARE

Neni 41

**Parandalimi i sëmundjeve dhe trajtimet
veterinare**

1. Parandalimi i sëmundjeve bazohet në përzgjedhjen e racave dhe llojeve, praktikat e mbarështimit blegtoral, ushqimin për kafshë me cilësi të lartë, aktivitetin fizik, densitetin e përshtatshëm të popullatës së kafshëve dhe strehimin e përshtatshëm, të mirëmbajtur në kushte higjienike.

2. Sëmundjet trajtohen menjëherë sapo konstatohen nga mjeku veterinar, për të shmangur vuajtjen e kafshëve.

3. Kur përdorimi i produkteve fitoterapeutike, homeopatike dhe produkteve të tjera të ngjashme nuk është i përshtatshëm ose efektiv, mund të përdoren produkte mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, të përcaktuara nga mjeku veterinar. Gjithashtu përcaktohen kufizime në lidhje me kohëzgjatjen e trajtimit mjekësor dhe periudhat e pezullimit.

4. Lejohet të përdoren produktet mjekësore veterinarë imunologjike.

5. Lejohen trajtimet lidhur me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 42

**Produktet mjekësore veterinarë dhe
parandalimi i sëmundjeve**

1. Produktet mjekësore veterinarë alopatiche, përfshirë antibiotikët, lëshohen me recetë nga veterineri për trajtimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 41 të këtij udhëzimi, ruhen në fermë në një vend të mbikëqyrur dhe regjistrohen sipas nenit 25 të këtij udhëzimi.

2. Produktet mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët dhe boluset e molekulave kimike alopatiche të sintetizuara nuk përdoren si trajtim parandalues.

3. Ndalohet përdorimi i substancave për nxitjen e rritjes ose prodhimit, përfshirë antibiotikët, koksidiostatikët dhe stimulues të tjerë artificialë për nxitjen e rritjes, si dhe hormonet ose substancat e

tjera të ngjashme që përdoren për kontrollin e riprodhimit ose për qëllime të tjera si induktimi ose sinkronizimi i afshit (*oestrus*).

4. Kur kafshët merren nga njësitë joorganike, zbatohen masa të veçanta si testet e kontrollit ose periudhat e karantinës, në varësi të rrethanave lokale.

Neni 43

Trajtimi mjekësor veterinar

1. Kur kafshët sëmuren ose lëndohen, trajtohen menjëherë, pavarësisht masave parandaluese.

2. Produktet mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, përdoren sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3, të nenit 41 të këtij udhëzimi.

3. Lëndët e para për ushqim për kafshë me origjinë minerale dhe aditivët ushqimorë, që përdoren në prodhimin organik, si dhe produktet fitoterapeutike dhe homeopatike përdoren me përparësi ndaj produkteve mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, ose antibiotikëve, me kusht që efekti i tyre terapeutik të jetë efektiv për llojin e kafshës dhe gjendjen që trajtohet.

4. Me përjashtim të vaksinimeve, trajtimeve për parazitë dhe skemave të detyrueshme të çrrënjësjes së sëmundjeve, në rastet kur kafsha ose grupi i kafshëve merr më shumë se tre kura trajtimesh me produkte mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, brenda një periudhe 12-mujore, ose më shumë se një kurë trajtimi, nëse cikli i tyre produktiv i jetës është më i shkurtër se një vit, kafsha në fjalë dhe prodhimi prej saj nuk shitet si organik dhe kafsha i nënshtrohet periudhave të kalimit të përcaktuara në nenet 28 dhe 29 të këtij udhëzimi.

Neni 44

Periudhat e pezullimit

1. Në kushte normale përdorimi, periudha e pezullimit ndërmjet përdorimit të fundit të produkteve mjekësore veterinarë alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, dhe prodhimit të produkteve organike nga ajo kafshë, është dyfishi i afatit të pezullimit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar dhe është të paktën 48 orë.

2. Nëse produkti mjekësor veterinar i përdorur nuk tregon periudhën e pezullimit për llojin e



kafshës, periudha e përcaktuar e pezullimit nuk është më pak se:

- a) 14 ditë për vezët;
- b) 14 ditë për qumështin;
- c) 56 ditë për mishin e shpendëve dhe gjitarëve, përfshirë dhjamin dhe të brendshmet.

Neni 45

Trajtimet për rastet veterinare të veçanta

1. Përdorimi i antibiotikëve kufizohet vetëm për rastet klinike dhe kur asnjë trajtim tjetër nuk është efektiv ose pas një traume të madhe si pasojë e një ndërhyrjeje kirurgjikale apo aksidenti.

2. Përdorimi terapeutik i hormoneve lejohet në situatat e mëposhtme:

a) hormonet përdoren te një kafshë vetëm si formë e trajtimit veterinar terapeutik, duke respektuar periudhat e përcaktuara të pezullimit;

b) prostaglandina ose kortikosteroidi natyral, përdoret nga veterineri, në raste të rralla kur nevojitet të nxitet lindja;

c) kërkohet miratim paraprak nga trupa e kontrollit për trajtimet hormonale për çrregullime të veçanta, kur nuk ka trajtime alternative dhe efektive për ta rikthyer kafshën në gjendje të plotë shëndetësore, si në rastin e lopëve me afshe (*anoestrus*).

3. Vaksinimi lejohet vetëm kur në fermë ose në një parcelë fqinje është identifikuar një risk për sëmundje, i konfirmuar nga një laborator zyrtar, që nuk mund të kontrollohet me asnjë mjet tjetër dhe është specifikuar në planin e shëndetit ose kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

4. Krahas përdorimit si aditivë në ushqimin për kafshë, mikroelementet dhe mineralet, mund të jepen nëpërmjet injeksioneve ose boluseve, në rast të mangësive të identifikuara në fermë dhe në planin e shëndetit.

5. Të gjitha veprimet përjashtimore, si prerja e bishtit të dhenve, prerja e pjesës së sipërme të sqepit të shpendëve dhe heqja e nyjës së bririt, si dhe ndërhyrje të tjera kirurgjikale, si kastrimi fizik, i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në nenin 16 të këtij udhëzimi.

KREU X

RREGULLAT E VEÇANTA PËR GJEDHËT, DHENTË, DHITË DHE NJËTHUNDRAKËT

Neni 46

Ushqyerja

1. Për ushqyerjen, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën 70% e ushqimit për kafshë prodhohet nga vetë ferma dhe kur nuk është e mundur prodhohet në bashkëpunim me njësitë e tjera të prodhimit organik ose në kalim dhe me operatorët e ushqimit për kafshë që përdorin ushqim për kafshë dhe lëndë të parë për ushqim për kafshë nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) kafshët kanë akses në kullota, kur e lejojnë kushtet klimatike;

c) pavarësisht përcaktimeve të shkronjës “b” të këtij neni, kafshët meshkuj të llojit gjedhë, mbi një vjeç, duhet të kenë akses në kullota ose zona të hapura;

ç) kur kafshët kanë akses në kullota gjatë periudhës së kullotjes dhe kur kushtet e strehimit dimëror i lejojnë kafshët të lëvizin lirshëm, hiqet detyrimi për të siguruar akses në zona të hapura gjatë muajve të dimrit;

d) sistemet e rritjes bazohen në përdorimin maksimal të kullotave, duke marrë parasysh disponueshmërinë e kullotave në periudha të ndryshme të vitit;

dh) të paktën 60% e lëndës së thatë në racionin ditor përbëhet nga ushqime me fibra bimore, foragjere të njoma ose të thara ose silazh. Kjo përqindje mund të reduktohet në 50% për kafshët që prodhojnë qumësht, për një periudhë maksimale prej tre muajsh, gjatë laktacionit të hershëm.

2. Periudha minimale për ushqyerjen e kafshëve që ushqehen me qumësht mundësisht qumështin e nënës, është:

a) 90 ditë pas lindjes për gjedhët dhe njëthundrakët;

b) 45 ditë pas lindjes për dhentë dhe dhitë.

Neni 47

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

1. Për strehimin dhe praktikat e mbarështimit të kafshëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:



a) stalla ka dyshe me të lëmuar, por jo të rrëshqitshme;

b) stalla siguron një zonë të rehatshme, të pastër dhe të thatë për shtrirje ose pushim, me madhësi të mjaftueshme, e cila përbëhet nga një ndërtim i pandarë me rrjetë. Në zonën e pushimit sigurohet shtrojë e bollshme, e thatë, me material të përshtatshëm si kashta ose materiale të tjera natyrale. Shtroja mund të përmirësohet dhe pasurohet me çdo produkt mineral që përdoret në prodhimin organik, si plehërues ose përmirësues toke;

c) pavarësisht legjislacionit në fuqi për standardet minimale për mbrojtjen e viçave, strehimi i viçave në bokse individuale ndalohet pas moshës njëjavëshe, përveç rasteve për arsye mjekësore veterinarë, për kafshë individuale dhe për një periudhë të kufizuar. Bokset e viçave ndërtohen të tilla që çdo viç të shohë dhe të dëgjojë viçat e tjerë dhe të ngrihet, shtrihet dhe rrotullohet pa vështirësi;

ç) kur një viç trajtohet individualisht për arsye mjekësore veterinarë, mbahet në hapësira me dyshe me pandarë dhe me shtrojë kashte. Viçi të ketë mundësi të rrotullohet lehtësisht dhe të shtrihet plotësisht në gjithë gjatësinë.

2. Për gjedhët, dhentë, dhitë dhe njëthundrakët, dendësia e popullatës së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për mjediset e brendshme dhe të jashtme, përcaktohen në Pjesën I të Aneksit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Të paktën gjysma e sipërfaqes minimale të mjedisit të brendshëm, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, përbëhet nga një ndërtim i pandarë me rrjetë ose grilë.

Neni 48

Veprimet përjashtimore dhe ndërhyrjet kirurgjikale

1. Pas miratimit të veprimeve përjashtimore, nga autoriteti kompetent i kontrollit zyrtar në fermë për gjedhët:

a) për heqjen e brirëve ose nyjës së bririt, sipas pikës 2 të nenit 16 të këtij udhëzimi:

i. rekomandohet më shumë heqja e nyjës së bririt sesa heqja e brirëve.

ii. heqja e nyjës së bririt të viçit kryhet pa mbushur 15 ditë.

iii. heqja e brirëve kryhet nga një mjek veterinar.

b) për kastrimin, sipas pikës 4 të nenit 16 të këtij udhëzimi:

i. kastrimi jokirurgjikal i demit, kryhet nën moshën 6 muajsh;

ii. përdorimi i një unaze gome për ndërprerjen e qarkullimit të gjakut në skrotumin e një demi, kryhet nën moshën 8-ditëshe.

2. Pas miratimit të veprimeve përjashtimore, nga autoriteti kompetent i kontrollit zyrtar në fermë për dhentë:

a) heqja e nyjës së bririt të qengjit ose kecit, kryhet pa mbushur moshën 8-ditëshe;

b) kastrimi jokirurgjikal i qengjit mashkull kryhet pa mbushur moshën 3-muajsh;

c) përdorimi i unazës prej gome për të ndërprerë qarkullimin e gjakut në skrotumin e qengjit mashkull, kryhet nën moshën 8-ditëshe;

ç) heqja e një pjese të bishtit të qengjit, kryhet nën moshën 8-ditëshe, duke përdorur një unazë prej gome për të ndërprerë qarkullimin e gjakut në bisht;

d) kastrimi jokirurgjikal i kecit kryhet pa mbushur moshën 2-muajsh;

dh) përdorimi i unazës prej gome për të ndërprerë qarkullimin e gjakut në skrotumin e kecit, kryhet nën moshën 8-ditëshe;

e) heqja e një pjese të bishtit të kecit, kryhet nën moshën 8-ditëshe, duke përdorur një unazë prej gome për të ndërprerë qarkullimin e gjakut në bisht.

KREU XI

RREGULLAT E VEÇANTA PËR DRERËT

Neni 49

Ushqyerja

1. Për ushqyerjen, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën 70% e ushqimit për kafshë prodhohet nga vetë ferma dhe kur nuk është e mundur prodhohet në bashkëpunim me njësitë e tjera të prodhimit organik ose në kalim dhe me operatorët e ushqimit për kafshë që përdorin ushqim për kafshë dhe lëndë të parë për ushqim për kafshë nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) kafshët kanë akses në kullota kur e lejojnë kushtet klimatike;

c) kur kafshët kanë akses në kullota gjatë periudhës së kullotjes dhe kur kushtet e strehimit dimëror i lejojnë kafshët të lëvizin lirshëm, hiqet detyrimi për të siguruar akses në zona të hapura gjatë muajve të dimrit;



ç) sistemet e rritjes bazohen në përdorimin maksimal të kullotave, duke marrë parasysh disponueshmërinë e kullotave në periudha të ndryshme të vitit;

d) të paktën 60% e lëndës së thatë në racionin ditor përbëhet nga ushqime me fibra bimore, foragjere të njoma ose të thara ose silazh. Kjo përqindje mund të reduktohet në 50% për kafshët që prodhojnë qumësht, për një periudhë maksimale prej 3 muajsh, gjatë laktacionit të hershëm.

dh) kullotja natyrale sigurohet në stallë, gjatë periudhës së vegetacionit. Stallat që, gjatë periudhës së vegetacionit, nuk ofrojnë ushqim për kafshë përmes kullotjes, nuk lejohen.

e) ushqimi për kafshë lejohet vetëm në rastin e pamjaftueshmërisë së kullotjes për shkak të kushteve të vështira të motit;

ë) kafshëve të fermës në stallë i sigurohet ujë i pastër dhe i freskët. Në rast se nuk ka një burim ujor natyror që është lehtësisht i aksesueshëm nga kafshët, sigurohen vende për pirjen e ujit.

2. Periudha minimale për ushqyerjen e drerëve që ushqehen me qumësht, mundësisht qumështin e nënës, është 90 ditë pas lindjes.

Neni 50

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

1. Për strehimin dhe praktikat e mbarështimit të drerëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) sigurohen vende për t'u fshehur, streha dhe gardhe që nuk dëmtojnë kafshët;

b) në stallat që mbajnë drerë të kuq, kafshët të jenë në gjendje të rrotullohen në baltë për të siguruar kujdesin e lëkurës dhe rregullimin e temperaturës së trupit;

c) çdo strehim ka dysheme të lëmuar, por jo të rrëshqitshme;

ç) çdo strehim siguron një zonë të rehatshme, të pastër dhe të thatë për shtrirje ose pushim, me madhësi të mjaftueshme, e cila përbëhet nga një ndërtim i pandarë me rrjeta. Në zonën e pushimit sigurohet shtrojë e bollshme, e thatë, me material të përshtatshëm si kashta ose materiale të tjera natyrale. Shtroja mund të përmirësohet dhe pasurohet me çdo produkt mineral që përdoret në prodhimin organik, si plehërues ose përmirësues toke.

d) vendet e ushqyerjes vendosen në zona të mbrojtura nga kushtet e motit dhe të aksesueshme për kafshët dhe për personat që kujdesen për to.

Toka ku vendosen vendet e ushqyerjes është e stabilizuar dhe pajisjet që përdoren për ushqyerjen e kafshëve janë të pajisura me një mbulesë;

dh) nëse nuk mund të sigurohet akses i përhershëm në ushqim për kafshë, vendet e ushqyerjes projektohen në mënyrë që i mundësojnë të gjitha kafshëve të ushqehen në të njëjtën kohë.

2. Për drerët, dendësia e popullatës dhe sipërfaqja minimale për mjediset e jashtme, përcaktohen në Pjesën II të Aneksit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Neni 51

Karakteristikat dhe kërkesat teknike për rrethimet e jashtme ose stallat

1. Kafshët e llojit drerët mbahen në rrethime të jashtme ose stalla që ofrojnë kullota, kur është e mundur nga kushtet.

2. Rrethimet e jashtme ose stallat ndërtohen në mënyrë që të jetë i mundur veçimi i llojeve të ndryshme të kafshëve të llojit drerë, nëse është e nevojshme.

3. Çdo rrethim i jashtëm ose stallë duhet jetë i ndarë në dy zona ose i vendosur pranë një tjetër rrethimi të jashtëm ose stalle, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i njëpasnjëshëm i masave të mirëmbajtjes në secilin rrethim të jashtëm ose stallë.

Neni 52

Kërkesat për vegetacionin dhe karakteristikat e mjediseve të mbrojtura dhe zonave të hapura

1. Drerëve i sigurohen mjedise që mundësojnë mbrojtje vizuale dhe nga kushtet e motit, mundësisht nëpërmjet strehave natyrale, si grumbujt e pemëve dhe shkurreve, pjesët e pyjeve ose zona përreth pyjeve në rrethimin e jashtëm ose stallën. Në rast se kjo nuk mund të sigurohet në një nivel të mjaftueshëm përgjatë gjithë vitit, atëherë sigurohen streha artificiale të mbuluara.

2. Rrethimet e jashtme ose stallat për kafshët e llojit drerë, pajisen me objekte ose mbulohen me bimësi, që i lejojnë kafshët të heqin lëkurën e butë nga brirët e tyre.

3. Në stadin e vonshëm të shtatzënisë dhe dy javë pas lindjes, kafshët femra të llojit drerë duhet të kenë akses në zona të mbuluara me bimësi, ku të fshehin të vegjlit e tyre.



4. Gardhet përreth rrethimeve të jashtme ose stallave ndërtohen në mënyrë që të pengojnë largimin e drerëve.

Neni 53

Veprimet përjashtimore dhe ndërhyrjet kirurgjikale te drerët

Tek drerët, lejohet përdorimi i një unaze prej gome për të ndërprerë qarkullimin e gjakut në skrotumin e drerit nën moshën 8-ditëshe.

KREU XII

RREGULLAT E VEÇANTA PËR DERRAT

Neni 54

Ushqyerja

1. Për ushqyerjen e derrave, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën 30% e ushqimit për kafshë prodhohet nga vetë ferma dhe, kur nuk është e mundur, prodhohet në bashkëpunim me njësitë e tjera të prodhimit organik ose ato në kalim dhe operatorët e ushqimit për kafshë që përdorin ushqim për kafshë dhe lëndë të parë për ushqim për kafshë nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) në racionin ditor shtohen ushqime me fibra bimore, foragjere të njoma ose të thata, ose silazh;

c) kur fermeri nuk mund të sigurojë ushqim për kafshë proteinik ekskluzivisht nga prodhimi organik, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimin për përdorimin e ushqimit për kafshë proteinik joorganik kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. nuk gjendet në formë organike;

ii. prodhohet ose përgatitet pa tretës kimikë;

iii. përdorimi kufizohet për ushqyerjen e gicave deri në 35 kg dhe përmban përbërës proteinikë të caktuar;

iv. përqindja maksimale e përdorur në 12 muaj për këto kafshë nuk kalon 5%, duke llogaritur përqindjen e lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bujqësore.

2. Periudha minimale për ushqyerjen e gicave me qumësht, mundësisht qumështin e nënës, është 40 ditë pas lindjes.

3. Në rastin e përjashtimit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet

formateve të miratuara në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

Neni 55

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

1. Për strehimin dhe praktikat e mbarështimit të derrave, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) stallat kanë dysheme të lëmuara, por jo të rrëshqitshme;

b) strehimi siguron një zonë të rehatshme, të pastër dhe të thatë për shtrirje ose zonë pushimi me madhësi të mjaftueshme, dysheme pa hapësira. Në zonën e pushimit sigurohet shtrojë e bollshme, e thatë, me material të përshtatshëm që përbëhet nga kashta ose materiale të tjera natyrale. Materiali i shtrojës mund të përmirësohet dhe pasurohet me çdo produkt mineral që përdoret në prodhimin organik, si plehërues ose përmirësues toke;

c) gjithmonë ka një shtrojë të përbërë nga kashta ose materiale të tjera të përshtatshme, mjaftueshëm e madhe për të siguruar që të gjithë derrat e mbajtur në stallë të mund të shtrihen në të njëjtën kohë, në mënyrë të rehatshme;

ç) dosat mbahen në grupe, përveç gjatë fazave të fundit të shtatzënisë dhe gjatë periudhës së mëmëzimit, ku dosa duhet të jetë në gjendje të lëvizë lirisht në boksën e saj dhe lëvizjet të kufizohet vetëm për periudha të shkurtra;

d) pa rënë ndesh me ndonjë kërkesë shtesë për kashtën, disa ditë përpara lindjes, dosave i sigurohet në sasi të mjaftueshme kashte ose material tjetër natyral i përshtatshëm, për të mundësuar ndërtimin e foleve;

dh) zonat e ushtrimit lejojnë derrat të kryejnë procesin natyral të eliminimit të mbeturinave nga trupi dhe gjermimit me noçkë në tokë. Për ti mundësuar derrave jashtëqitjen dhe gjermimin me noçkë, mund të përdoren materiale të ndryshme.

2. Për kafshët e llojit derra, dendësia e popullatës dhe sipërfaqja minimale për mjediset e brendshme dhe të jashtme, përcaktohen në pjesën III të aneksit të këtij udhëzimi.



Neni 56

Karakteristikat dhe kërkesat teknike për sipërfaqen minimale për zonat e brendshme dhe të jashtme

1. Të paktën gjysma e sipërfaqes minimale të zonave të brendshme dhe të jashtme, e përcaktuar në pjesën III të aneksit të këtij udhëzimi, duhet të jetë një ndërtim me hapësirë të kufizuar me rrjete.

2. Zonat e hapura duhet të jenë tërheqëse për derrat. Kur është e mundur, sipërfaqe me fusha me pemë ose pyje.

3. Zonat e hapura, në varësi të kushteve klimatike të jashtme, duhet të sigurojnë akses në streha dhe mjete për rregullimin e temperaturës trupore të derrave.

4. Njësia për rritjen e derrave mundëson rritjen në gjendje të lirë dhe lejon derrat të kenë akses të drejtpërdrejtë në tokë dhe ushqim të gjelbër. Gjatë muajve të verës sigurohen zona për zhgërryerje në baltë dhe zona me hije.

Neni 57

Veprimet përjashtimore dhe ndërhyrjet kirurgjikale te derrat

1. Për kafshët e llojit derra, me miratimin nga autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë lejohet kryerja e veprimeve të mëposhtme:

a) kastrimi i derrit, që nuk ka mbushur 8 ditë, nëpërmjet një metode që nuk përfshin shkëputjen e indeve.

b) heqja e një pjese të bishtit të derrit që nuk ka mbushur 8 ditë.

c) heqja e dhëmbëve anësorë të derrit që nuk ka mbushur 8 ditë.

2. Përpara kryerjes së manipulimeve sipas pikës 1 të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet formateve të miratuara në përputhje me pikën 6 të nenit 24 të ligjit.

KREU XIII

RREGULLAT E VEÇANTA PËR SHPENDËT

Neni 58

Origjina e shpendëve

1. Me qëllim parandalimin e përdorimit të metodave intensive të rritjes, shpendët rriten deri në

një moshë minimale ose vijnë nga raca shpendësh me rritje të ngadaltë, të përshtatura për rritje në mjedise të jashtme.

2. Lista e racave të shpendëve me rritje të ngadaltë përcaktohet nga legjislacioni në fuqi për shërbimin veterinar.

3. Në rastin kur fermeri nuk përdor raca shpendësh me rritje të ngadaltë, mosha minimale për therje është si vijon:

- a) 81 ditë për pulat;
- b) 150 ditë për gjelat e kastruar;
- c) 49 ditë për rosat e racës pekineze;
- ç) 70 ditë për rosat femra Muscovy;
- d) 84 ditë për rosakët meshkuj Muscovy;
- dh) 92 ditë për rosat Mallard;
- e) 94 ditë për shpendët Guinea;
- ë) 140 ditë për gjelat e detit dhe patat për pjekje;
- f) 100 ditë për pulat e detit.

4. Në përjashtim nga pika 1, e nenit 26 të këtij udhëzimi, në rastet e krijimit për herë të parë të tufës, ose ripërtëritjes apo rikrijimit të saj, dhe kur nuk plotësohen nevojat cilësore dhe sasiore të fermerit për shpendë organike, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton hyrjen në njësinë e prodhimit organik të shpendëve joorganike, me kusht që zogjtë e pulave për vezë dhe shpendët për mish të jenë të moshës më pak se 3-ditëshe.

5. Produktet e prodhuara nga kafshët e sjella në njësinë e prodhimit organik sipas pikës 4 të këtij neni, konsiderohen organike vetëm kur plotësohet periudha e kalimit, e përcaktuar në nenet 28 dhe 29 të këtij udhëzimi.

6. Përpara hyrjes së shpendëve joorganike në njësinë e prodhimit organik, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet formateve të miratuara në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

7. Heqja e pendëve të shpendët e gjallë, është e ndaluar.

8. Shkurtimi i sqepave të shpendëve, nuk lejohet.

Neni 59

Ushqyerja

1. Për ushqyerjen e shpendëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën 30% e ushqimit për kafshë prodhohet nga vetë ferma dhe kur nuk është e mundur prodhohet në bashkëpunim me njësitë e tjera të prodhimit organik ose në kalim dhe



operatorët e ushqimit për kafshë që përdorin ushqim për kafshë dhe lëndë të parë për ushqim për kafshë nga territori i Republikës së Shqipërisë.

b) në racionin ditor shtohen ushqime me fibra bimore, foragjere të njoma ose të thata, ose silazh;

c) kur fermeri nuk mund të sigurojë ushqim për kafshë proteinik ekskluzivisht nga prodhimi organik, autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë miraton përjashtimin për përdorimin e ushqimit për kafshë proteinik joorganik kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. nuk gjendet në formë organike;

ii. prodhohet ose përgatitet pa tretës kimikë;

iii. përdorimi i tij kufizohet për ushqyerjen e zogjve të pulave dhe të përmbajë përbërës proteinikë të caktuar;

iv. përqindja maksimale e përdorur në 12 muaj për këto kafshë nuk kalon 5%, duke llogaritur përqindjen e lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bujqësore.

2. Në rastin e përjashtimit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, operatori aplikon në portalin qeveritar *e-Albania* nëpërmjet formateve të miratuara në përputhje me pikën 6, të nenit 24 të ligjit.

Neni 60

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

1. Për strehimin dhe praktikat e mbarështimit të shpendëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën një e treta e dyshemesë është e pandarë me rrjetë ose grilë, dhe mbulohet me shtrojë të thatë prej kashte, tallash druri, rëre ose torfe;

b) në kotecet për mbajtjen e pulave për vezë, një pjesë e mjaftueshme e sipërfaqes së dyshemesë përdoret për mbledhjen e jashtëqitjeve të shpendëve.

c) pas largimit të tufës së shpendëve të rritur, ndërtesat zbrazen dhe pastrohen dhe dezinfektohen bashkë me pajisjet. Përveç kësaj, zonat e jashtme lihen bosh për një periudhë prej 6 muajsh për shpendët që prodhojnë vezë dhe 2 muaj për shpendët që prodhojnë mish, për rigjenerimin e bimësisë. Operatori mban të dhëna ose dokumentacion në lidhje me respektimin e këtyre periudhave.

Këto kërkesa nuk zbatohen në rastet kur shpendët nuk rriten në tufa, nuk mbahen në mjedise të jashtme dhe lihen të lira të lëvizin gjatë ditës;

ç) shpendët kanë akses në zona të hapura për të paktën një të tretën e jetës së tyre me përjashtim të rasteve kur vendosen kufizime të përkohshme për pulat për vezë dhe broilerat, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar;

d) akses i vazhdueshëm, gjatë ditës, në zona të hapura mundësohet në moshë sa më të hershme dhe kur lejohet nga kushtet fiziologjike dhe fizike, përveç rasteve të kufizime të përkohshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar;

dh) në përjashtim nga pika 2 e nenit 14 të këtij udhëzimi, në rastin e shpendëve riprodhues dhe shpendëve nën moshën 18-javëshe, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 14 të këtij udhëzimi në lidhje me kufizimet dhe detyrimet për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, atëherë verandat konsiderohen si zona të hapura dhe duhet të kenë një rrethim me rrjetë për të penguar hyrjen e shpendëve të tjerë.

e) zonat e hapura për shpendët i mundësojnë pulave të kenë lehtësisht akses në një numër të mjaftueshëm enësh për të pirë ujë;

ë) zonat e hapura për shpendët janë kryesisht me bar/bimësi;

f) në kushtet kur ushqimi për kafshë në zonën e hapur është e kufizuar, si në rastet e mbulimit për një kohë të gjatë me dëborë ose thatësi të motit, përfshihet si pjesë e dietës së shpendëve ushqim për kafshëplotësues, me fibra bimore.

g) kur shpendët mbahen në mjedise të brendshme për shkak të kufizimeve ose detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi, ato kanë akses të përhershëm në sasi të mjaftueshme të ushqimeve me fibra bimore dhe lëndë të përshtatshme, për të plotësuar nevojat e tyre etologjike.

gj) shpendët e ujit kanë akses në një rrjedhë uji, pellg, liqen ose rezervuar, kur është e mundur nga kushtet e motit dhe higjienike, me qëllim që të respektohen nevojat e llojeve të veçanta të shpendëve dhe kërkesat e mirëqenies së tyre. Kur kushtet e motit nuk lejojnë një akses të tillë, shpendët e ujit kanë akses në ujë, për të zhytur kokën dhe për të pastruar pendët;

h) drita natyrale plotësohet me artificiale për të siguruar maksimumi 16 orë ndriçim në ditë, me një periudhë ndërprerje të vazhdueshme të dritës gjatë natës, për të paktën 8 orë;

i) sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzueshme në strehimet e shpendëve për mish, në çdo njësi prodhimi, nuk kalon 1,600 m²;



j) nuk lejohen më shumë se 3,000 pula për vezë për kaponon shpendësh.

2. Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për mjediset e brendshme dhe të jashtme përcaktohen në Aneksin e këtij udhëzimi.

Neni 61

Kërkesat teknike për strehimet e shpendëve

1. Strehimet e shpendëve ndërtohen të tillë që të gjithë zogjtë të kenë lehtësisht akses në zona të hapura. Për këtë qëllim, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) kufiri i jashtëm i strehimit duhet të ketë hapësira për hyrjen/daljen e shpendëve, drejtpërdrejtë në zonat e hapura;

b) çdo hapje për hyrje-dalje është në madhësi të përshtatshme për zogjtë;

c) zogjtë duhet të jenë në gjendje t'i aksesojnë hapjet e hyrje-daljeve pa pengesë;

ç) hapjet e hyrjeve-daljeve nga kufiri i jashtëm kanë një gjatësi të përgjithshme prej të paktën 4 m për 100 m² të sipërfaqes së hapësirës minimale të shfrytëzueshme brenda strehimit;

d) kur hapjet e hyrjeve/daljeve janë të ngritura, sigurohet një platformë e pjerrët.

2. Për strehimet e shpendëve me veranda, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) kufiri i jashtëm nga brenda vendqëndrimit të veranda dhe nga veranda të zona e hapur të ketë hapje hyrje-daljeje, që mundësojnë akses të lirshëm respektivisht në verandë ose në zonën e hapur;

b) hapjet për hyrje-dalje nga brenda vendqëndrimit në verandë kanë një gjatësi të përgjithshme prej të paktën 2 m për 100 m² të sipërfaqes së hapësirës minimale të shfrytëzueshme të mjedisit të brendshëm të strehimit dhe hapjet për hyrje-dalje nga veranda në zonën e hapur të ketë një gjatësi të përgjithshme prej të paktën 4 m për 100 m² të sipërfaqes së hapësirës minimale të shfrytëzueshme të brendshme të strehimit;

c) sipërfaqja e shfrytëzueshme e verandës nuk merret në konsideratë për llogaritjen e dendësisë së mbajtjes së shpendëve dhe hapësirës minimale të mjedisëve të brendshme dhe të jashtme, të përcaktuara në pjesën IV, të aneksit të këtij udhëzimi. Megjithatë, në llogaritjen e dendësisë së mbajtjes së shpendëve dhe hapësirës minimale të mjedisëve të brendshme dhe të jashtme, përfshihet një pjesë shtesë e jashtme dhe e mbuluar e

vendqëndrimit të shpendëve që përdoret për shpendët, e izoluar në një mënyrë që nuk ndikohet nga kushtet e motit, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. është plotësisht e aksesueshme 24 orë në ditë;

ii. përputhet me kërkesat e pikës 2 dhe 4 të nenit 34 të këtij udhëzimi;

iii. përputhet me të njëjtat kërkesa për hapjet e hyrje-daljeve për verandat, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike;

ç) sipërfaqja e shfrytëzueshme e verandës nuk përfshihet në sipërfaqen e përgjithshme të shfrytëzueshme të strehimeve për shpendët në majmëri siç përcaktohet në shkronjën “i”, të pikës 1, të nenit 60 të këtij udhëzimi.

3. Për strehimet me nën-ndarje në hapësira të veçanta për të strehuar tufa të ndryshme:

a) ndarjet duhet të sigurojnë kufizimin e kontaktit me tufat e tjera dhe ndalojnë përzierjen e zogjve nga tufat e ndryshme në strehim;

b) madhësia maksimale e tufës në një ndarje të vetme të strehimit, është si më poshtë:

i. 3,000 prindër të llojit *Gallus gallus*;

ii. 10,000 zogj pule;

iii. 4,800 shpendë për mish të llojit *Gallus gallus*;

iv. 2,500 gjela të kastruar;

v. 4,000 pula të rritura për mish;

vi. 2,500 gjela deti;

vii. 2,500 pata;

viii. 3,200 rosakë meshkuj të racës pekinaze ose 4,000 rosa femra të racës pekinaze;

ix. 3,200 rosakë meshkuj të racës *Muscovy* ose 4,000 rosa femra të racës *Muscovy*;

x. 3,200 rosakë meshkuj të egër ose 4,000 rosa femra të egra;

xi. 5,200 shpendë *Guinea*.

c) kapononet veçohen nga panele solide për shpendët në majmëri, përveç llojit *Gallus gallus*. Këto panele ndarës sigurojnë veçim të plotë fizik nga dyshemeja deri në çatinë e ndërtesës, për çdo kaponon të strehimit;

ç) ndarjet veçohen nga panele të plota ose gjysmë të mbyllura ose rrjeta për shpendët prindëror të llojit *Gallus gallus*, pulat për vezë, zogjtë e pulës, gjelat dhe shpendët për mish të llojit *Gallus gallus*.

4. Në strehim mund të përdoren sistemet e mbajtjes me shumë kate dhe zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) këto sisteme përdoren vetëm për shpendët prind të llojit *Gallus gallus*, pulat për vezë, zogjtë e



pulës për prodhim vezësh, zogjtë e pulës për t'u përdorur si prindër në të ardhmen dhe gjelat;

b) këto sisteme mund të kenë më shumë se tre kate të shfrytëzueshme, duke përfshirë katin e parë;

c) katet në lartësi ndërtohen të tillë që të pengojnë rënien e glasave mbi zogjtë në katet e mëposhtme dhe pajisen me një sistem eficient për heqjen e jashtëqitjeve;

ç) të gjitha katet krijojnë mundësi për inspektimin e zogjve;

d) këto sisteme sigurojnë që zogjtë të lëvizin lirisht dhe lehtësisht nëpër kate të ndryshme ose në zona të ndërmjetme;

dh) këto sisteme ndërtohen të tilla që të mundësojnë akses të lirshëm dhe të barabartë në zonat e hapura për zogjtë.

5. Strehimet e shpendëve pajisen me struktura për qëndrimin e zogjve (shkallare) me një ose disa nivele, ose të dyja njëkohësisht. Strukturat me një ose disa nivele për qëndrimin e zogjve në moshë të vogël, të kenë përmasa dhe proporcione në përputhje me madhësinë e grupit të zogjve, të përcaktuar në pjesën IV, të aneksit të këtij udhëzimi.

6. Për shpendët mund të përdoren strehime të lëvizshme, me kusht që të zhvendosen rregullisht gjatë ciklit të prodhimit, për sigurimin e vegjetacionit për zogjtë dhe të paktën ndërmjet çdo grupi shpendësh. Dendësia e mbajtjes së shpendëve në majmëri, e përcaktuar në pjesën IV, të aneksit të këtij udhëzimi, mund të rritet deri në një maksimum prej 30 kg peshë e gjallë/m², me kusht që sipërfaqja e katit të parë të strehimit të lëvizshëm të mos kalojë 150 m².

Neni 62

Kërkesat për vegjetacionin dhe karakteristikat e zonave të hapura

1. Zonat e hapura që përdoren për shpendët të jenë plotësisht të aksesueshme prej tyre.

2. Për strehimet e shpendëve të ndara në kapanone të veçanta për të strehuar disa tufa, zonat e hapura për çdo kapanon, ndahen për të kufizuar kontaktin dhe penguar përzierjen me zogjtë e tufave të tjera.

3. Zonat e hapura që përdoren për shpendë mbahen kryesisht me bimësi, të përbërë nga një larmi bimësh.

4. Zonat e hapura ofrojnë për zogjtë një numër të mjaftueshëm mjedisesesh mbrojtëse, ose

strehëzash, shkurresh, pemësh, të shpërndara në të gjitha zonat e hapura, për të siguruar përdorimin e gjithë zonës së hapur në mënyrë të balancuar nga zogjtë.

5. Bimësia në zonën e hapur mirëmbahet rregullisht për të reduktuar mundësinë tepricave të lëndëve ushqyese.

6. Zonat e hapura nuk shtrihen përtej rrezes prej 150 m nga hyrja/dalja më e afërt e strehimit të shpendëve. Megjithatë, lejohet zgjerimi deri në 350 m nga hyrja/dalja më e afërt, me kusht që një numër i mjaftueshëm strehimesh për mbrojtje nga moti dhe grabitqarët, të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë zonën e hapur, me të paktën katër strehime për hektar. Për patat, zona e hapur duhet t'i mundësojë shpendëve plotësimin e nevojave për të ngrënë bar.

7. Shpendët kanë në çdo kohë akses në strehë dhe i sigurohet mbulim dhe mbrojtje e përshtatshme nga grabitqarët, përfshirë dhelprat, dhe nga kushtet ekstreme të motit, si shiu, era, dielli dhe temperaturat e larta.

KREU XIV

RREGULLAT E VEÇANTA PËR LEPUJT

Neni 63

Ushqyerja

1. Për ushqyerjen e lepujve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) të paktën 70% e ushqimit për kafshë prodhohet nga vetë ferma dhe kur nuk është e mundur prodhohet në bashkëpunim me njësitë e tjera të prodhimit organik ose në kalim dhe operatorët e ushqimit për kafshë që përdorin ushqim për kafshë dhe lëndë të parë për ushqim për kafshë nga territori i Republikës së Shqipërisë

b) lepujt kanë akses në kullota, kur e lejojnë kushtet klimatike;

c) sistemet e rritjes bazohen në përdorimin maksimal të kullotave, duke marrë parasysh disponueshmërinë e kullotave në periudha të ndryshme të vitit;

ç) kur bari nuk është i mjaftueshëm, sigurohet ushqim me fibra për kafshë si kashta ose bari i thatë. Foragjeret përbëjnë të paktën 60% të dietës.

2. Periudha minimale për ushqyerjen e lepujve të vegjël me qumësht, mundësisht qumështin e nënës, është 42 ditë pas lindjes.



Neni 64

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

1. Për strehimin dhe mbarështimin e lepujve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) strehimi siguron një zonë të rehatshme, të pastër dhe të thatë për shtrirje ose pushim, me madhësi të mjaftueshme, solide dhe uniforme (pa hapësira). Në zonën e pushimit sigurohet shtrojë e bollshme, e thatë, me material të përshtatshëm që përbëhet nga kashta ose materiale të tjera natyrale. Materiali i shtrojës përmirësohet dhe pasurohet me produkte minerale që përdoren në prodhimin organik, si plehërues ose përmirësues toke;

b) lepujt mbahen në grupe;

c) fermat e lepujve përdorin raca rezistente ndaj kushteve të jashtme;

ç) lepujt kanë akses në:

i. strehëza të mbuluara, përfshirë vende të errëta për t'u fshehur;

ii. hapësira të jashtme me bimësi, mundësisht kullotë;

iii. platforma të ngritura ku qëndrojnë ulur, brenda ose jashtë;

iv. materiale për ndërtimin e foleve, për lepujt femra.

2. Dendësia e mbajtjes së lepujve dhe sipërfaqja minimale për mjediset e brendshme dhe të jashtme përcaktohen në Pjesën V të Aneksit të këtij udhëzimi.

Neni 65

Kërkesat teknike për strehimet e lëvizshme ose të palëvizshme

1. Gjatë sezonit të kullotjes, lepujt mbahen në strehëza të lëvizshme në kullota ose të palëvizshme, që kanë akses në kullota.

2. Jashtë sezonit të kullotjes, lepujt mbahen në strehime të palëvizshme me akses në hapësirë të jashtme me bimësi, mundësisht kullotë.

3. Strehimet e lëvizshme të lepujve në kullota lëvizten sa më shpesh të jetë e mundur për të siguruar përdorimin maksimal të kullotës dhe ndërtohen të tilla që të mundësojnë ushqyerjen direkt nga toka në kullotë.

Neni 66

Kërkesat teknike për zonat e brendshme dhe të jashtme

1. Zona e brendshme e strehës së lëvizshme dhe të palëvizshme ndërtohet e tillë që:

a) lartësia të jetë e mjaftueshme për t'i lejuar lepujt të qëndrojnë mbi dy këmbë dhe me veshë të ngritur;

b) të mbajë grupe të ndryshme lepujsh dhe të lejojë ruajtjen e identitetit dhe strukturës së të vegjëlve, pas transferimit në fazën e majmërisë;

c) të kryhet veçimi i lepujve meshkuj dhe femra shtatzënë dhe në fazë riprodhimi, për arsye të mirëqenies së kafshëve dhe për një periudhë të kufizuar, me kusht që të ruhet kontakti me sy me lepujt e tjerë;

ç) lepujt femra të largohen dhe kthehen në fole për ushqyerjen e të vegjëlve;

d) të sigurojë:

i. strehë të mbuluar, përfshirë një numër të mjaftueshëm vendesh të errëta për t'u fshehur, për të gjitha kategoritë e lepujve;

ii. akses në fole për lepujt femra, të paktën një javë përpara datës së pjelljes dhe të paktën deri në fund të periudhës së ushqyerjes me qumësht të të vegjëlve;

iii. akses në një numër të mjaftueshëm folesh për të vegjlit, me të paktën një fole për çdo lepur femër që ushqen të vegjlit e saj;

iv. materiale që i lejojnë lepujve të brejnë.

2. Zona e jashtme në mjedise me streha të palëvizshme ndërtohet e tillë që:

a) të ketë një numër të mjaftueshëm platformash të ngritura dhe të shpërndara në mënyrë të barabartë në sipërfaqen e saj minimale;

b) të jetë i rrethuar nga gardhe mjaftueshëm të larta dhe të thella për të penguar arratisjen, qoftë nëpërmjet kërcimit apo gërmimit;

c) kur ka një zonë të jashtme prej betoni, sigurohet akses në pjesën e jashtme me bimësi. Kur nuk sigurohet ky akses, sipërfaqja e zonës prej betoni nuk përfshihet në llogaritjen e sipërfaqes minimale të zonës së jashtme;

ç) të sigurojë:

i. strehë të mbuluar, përfshirë një numër të mjaftueshëm vendesh të errëta për t'u fshehur, për të gjitha kategoritë e lepujve;

ii. materiale që i lejojnë lepujve të brejnë.



Neni 67

Kërkesat për bimësinë në zonat e hapura

1. Bimësia në zonat e jashtme mirëmbahet rregullisht që të jetë tërheqëse për lepujt.
2. Gjatë sezonit të kullotjes, kullotat ndryshohen rregullisht me rotacion që të përmirësohet kullotja e lepujve.

KREU XV**RREGULLAT E VEÇANTA PËR BLETËT**

Neni 68

Origjina

1. Në bletari përdoret me përparësi *Apis mellifera* dhe ekotipet lokale.
2. Zgjojet e bletëve formohen nga ndarja e kolonive ose marrja e zgjojeve nga njësi organike.
3. Në përjashtim nga pika 1 e nenit 26 të këtij udhëzimi, për ripërtëritjen e zgjojeve të bletëve, 20% në vit e mbretëreshave dhe zgjojeve në njësinë e prodhimit organik mund të zëvendësohen me joorganike, me kusht që ato të vendosen në zgjoje me hoje ose fletë dylli me baza hojesh nga njësi të prodhimit organik. Gjatë një viti, mund të zëvendësohet vetëm një zgjua ose një mbretëreshë me një joorganike.

Neni 69

Ushqyerja

Për ushqyerjen e bletëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) në fund të sezonit të prodhimit zgjojet lihen me rezerva të mjaftueshme mjalti dhe poleni për bletët që të mbijetojnë gjatë dimrit;
- b) kolonitë e bletëve ushqehen me produkte organike të mjaltit, polenit, shurupit të sheqerit ose sheqerit, vetëm kur mbijetesa e tyre vihet në rrezik nga kushtet klimatike.

Neni 70

Kujdesi shëndetësor

Për kujdesin shëndetësor të bletëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) për të mbrojtur kornizat, zgjojet dhe hojet nga dëmtuesit, lejohen vetëm rodenticidet (preparatet kundër brejtësve) që përdoren në kurthe, si dhe

produktet e substancat që përdoren në prodhimin organik;

- b) lejohen trajtimet fizike për dezinfektimin e mjediseve të bletarisë, me avull ose flakë të drejtpërdrejtë;

c) praktika e shkatërrimit të larvave meshkuj lejohet vetëm me qëllim izolimin e infektimit nga *Varroa destructor-varroatoza*;

ç) kur kolonitë sëmuren ose infektohen, pavarësisht masave parandaluese, ato trajtohen menjëherë dhe vendosen në mjedise bletarie të izoluar;

d) acidi formik, acidi laktik, acidi acetik dhe acidi oksalik, si dhe mentoli, timoli, eukaliptoli ose kamfori, përdoren në rastet e infeksionit me *Varroa destructor*;

dh) kur aplikohet një trajtim me produkte alopatiche të sintetizuara kimikisht, përfshirë antibiotikët, përveç produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin organik, kolonitë e trajtuara vendosen në mjedise bletarie të izoluar dhe dylli zëvendësohet me dyllë nga bletaria organike. Për këto koloni, zbatohet periudha e kalimit prej 12 muajsh.

Neni 71

Vendosja e zgjojeve të bletëve ose parku i bletëve

1. Zgjojet vendoset në zona që sigurojnë burime të nektarit dhe polenit, që përbëhen kryesisht nga kultura të prodhuara në mënyrë organike ose nga bimësi spontane ose pyje apo kultura joorganike, që trajtohen vetëm me metoda me ndikim të ulët mjedisor.

2. Zgjojet e bletëve mbahen në distancë të mjaftueshme nga burimet që mund të kontaminojnë produktet e bletarisë ose përkeqësojnë shëndetin e bletëve.

3. Vendosja e zgjojeve të bletëve është e tillë që, brenda një rrezeje prej 3 km, burimet e nektarit dhe polenit përbëhen kryesisht nga kultura të prodhuara në mënyrë organike dhe/ose bimësi spontane apo kultura të trajtuara me metoda me ndikim të ulët mjedisor, që nuk ndikojnë negativisht në statusin organik të prodhimit të bletarisë. Kjo kërkesë nuk zbatohet ku nuk ka lulëzim apo kur kolonitë e bletëve janë të fjetura.

4. Bletaria nuk konsiderohet organike kur mbarështohet në rajone ose zona të ndotura, të



përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedisin.

5. Bletari siguron për autoritetin përgjegjës për kontrollin zyrtar në fermë:

a) një hartë në shkallë të përshtatshme, ku identifikohet vendndodhja e zgjojeve të bletëve dhe të dhëna të hollësishme për ushqyerjen e bletëve;

b) dokumentacionin që tregon se zonat e aksesueshme nga kolonitë përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 72

Mirëqenia e bletëve

Për bletarinë, zbatohen rregullat të përgjithshme si më poshtë:

a) ndalohet asgjësimi i bletëve në hoje, gjatë vjeljes së produkteve të bletarisë;

b) ndalohen manipulime të tilla, si prerja e krahëve të mbretëreshave.

Neni 73

Strehimi dhe praktikat e mbarështimit

Për strehimin dhe mbarështimin e bletëve, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) zgjojet dhe materialet e përdorura në bletari përbëhen kryesisht nga materiale natyrore që nuk paraqesin rrezik ndotjeje të mjedisit ose të produkteve të bletarisë;

b) dylli i bletëve për krijimin e familjeve të reja sigurohet nga njësitë e prodhimit organik;

c) në zgjua përdoren vetëm produkte natyrale si propolisi, dylli dhe vajrat bimorë;

ç) repelentët e sintetizuar kimikisht nuk përdoren gjatë nxjerrjes së mjaltit;

d) hojet që mbajnë vezët nuk përdoren për nxjerrjen e mjaltit.

KREU XVI

MBAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 74

Ndarja e prodhimit blegtoral organik dhe joorganik

1. Kur të gjitha njësitë e prodhimit të një ferme nuk menaxhohen sipas rregullave të prodhimit organik, operatori mban regjistra të përshtatshëm

për të treguar ndarjen efektive të njësive të prodhimit dhe produkteve.

2. Kur një operator, përveç njësisë organike ose në kalim, menaxhon edhe një fermë ose stabiliment bujqësor, duhet të zbatojë ndarjen fizike, financiare dhe operacionale ndërmjet fermave ose stabilimenteve bujqësore, siç përcaktohet në nenin 4 të këtij udhëzimi.

Neni 75

Plani i menaxhimit të kafshëve

1. Plani i menaxhimit të kafshëve, siç përcaktohet në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 11 të këtij udhëzimi, hartohet dhe mbahet nga fermeri në lidhje me:

a) ndarjen e kafshëve organike dhe joorganike, dhe masat për ndarjen fizike, financiare dhe operacionale;

b) programin për periudhën e kalimit të kafshëve, që përfshin:

i. datën e fillimit dhe përfundimit të kalimit për çdo njësi toke;

ii. marrëveshjen e kalimit, qoftë kalim i njëkohshëm ose jo;

iii. datën kur kafsha dhe produktet shtazore tregtohen si organike;

iv. strehimin e kafshëve, përfshirë informacionin për çdo strehë/stallë/kapanon lidhur me përdorimin, përmasat, sipërfaqen dhe numrin maksimal të kafshëve;

v. ushqimin për kafshë.

2. Operatori mban regjistra ose dokumentacion për zbatimin e rregullave të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 16 dhe pikën 11, të nenit 34 të këtij udhëzimi.

Neni 76

Regjistrat për lëvizjen e kafshëve

1. Për kafshët që largohen nga ferma, regjistrohen të dhënat si moshë, numri i kafshëve, peshë e kafshëve të therura, identifikimi sipas kafshës ose grupit/tufës/zgjoit, data e largimit dhe destinacioni. Lëvizja e kafshëve dokumentohet me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së tyre, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin veterinar.

2. Regjistrat për lëvizjen e kafshëve përmbajnë të dhënat e përcaktuara në nenin 21 të këtij udhëzimi.



Neni 77

Regjistrat për ushqimin për kafshë

1. Operatorët mbajnë regjistra për regjimin ushqimor për kafshën dhe periudhën e kullotjes.
2. Regjistrat përmbajnë të dhëna lidhur me:
 - a) emrin e ushqimit për kafshët, përfshirë të gjitha format e ushqimit për kafshë të përdorura, si:
 - i. ushqim për kafshë i përbërë;
 - ii. raportet e lëndëve të para të ushqimit për kafshë në racion dhe raportet e ushqimit për kafshë nga vetë ferma ose i njëjti rajon;
 - b) periudha e aksesit në kullotë;
 - c) periudha e shtegimit për të cilat zbatohen kufizime;
 - ç) dokumentacionin sipas përcaktimeve të neneve 7, 8 dhe 38 të këtij udhëzimi.
2. Regjistrat për ushqimin për kafshë përmbajnë të dhënat e përcaktuara në nenin 23 të këtij udhëzimi.

Neni 78

Regjistrat për kullotjen

1. Regjistrat për ushqimin për kafshë përfshijnë:
 - a) informacion të hollësishëm për kullotjen e përbashkët;
 - b) informacion të hollësishëm për shtegtimin.
2. Informacioni për kullotjen e kafshëve joorganike, sipas rregullit për 180 ditë, përfshin:
 - a) datën e hyrjes dhe daljes;
 - b) të dhëna për kullotjen në tokat e kullotura;
 - c) statusin organik ose joorganik të kafshëve;
 - ç) furnizuesin dhe certifikimin organik të tij, nëse është organik.

Neni 79

Plani i shëndetit

1. Plani i shëndetit, siç përcaktohet në nenin 24 të këtij udhëzimi, hartohet dhe mbahet nga fermeri me mbështetjen e veterinerit privat, të njohur nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar. Ky plan hartohet gjatë dhe pas periudhës së kalimit, me qëllim krijimin dhe funksionimin e një sistemi organik blegtoral.
2. Plani siguron ruajtjen e shëndetit dhe kontrollin e sëmundjeve nëpërmjet masave të përshtatshme me rrethanat e veçanta të vetë fermës dhe lejon zhvillimin e sistemit blegtoral në mënyrë

progresive, sa më pak të varur nga produktet alopatiche mjekësore veterinare.

3. Kur ka përfunduar rritja e secilës tufë shpendësh, hapësirat në mjediset e jashtme lihen bosh gjatë një periudhe të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 60, të këtij udhëzimi. Operatori mban regjistra ose dokumentacion në lidhje me zbatimin e kësaj periudhe.

Neni 80

Regjistrat për trajtimet veterinare

1. Operatorët mbajnë regjistra ose dokumentacion për çdo trajtim, sipas pikës 4 të nenit 43 të këtij udhëzimi.
2. Regjistri përmban të dhëna që:
 - a) identifikojnë kafshët e trajtuara;
 - b) datën e trajtimit;
 - c) diagnozën, dozën;
 - ç) emrin e produktit të trajtimit dhe, kur është e mundur, recetën veterinare;
 - d) periudhën e pezullimit të zbatuar përpara se produktet blegtorale të etiketohen dhe vendosen në treg si organike.

Neni 81

Produktet e përdorura për pastrimin dhe dezinfektimin

Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e produkteve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 17 të këtij udhëzimi, përfshirë emrin dhe datën e përdorimit të produktit, lëndën aktive si dhe vendin e përdorimit të tij.

Neni 82

Mbajtja e të dhënave nga bletarët

1. Operatorët mbajnë një hartë në shkallë të përshtatshme ose koordinata gjeografike të vendndodhjeve të zgjojeve, që i ofrohet trupës së kontrollit, që tregon se zonat e aksesueshme nga kolonitë e bletëve përmbushin kërkesat e këtij udhëzimi.
2. Në regjistrin e zgjojeve të bletës përfshihet informacioni për ushqyerjen si emri i produktit, data, sasia dhe zgjojet ku është përdorur.
3. Zona ku janë vendosur zgjojet e bletëve regjistrohet bashkë me identifikimin e zgjojeve dhe periudhën e lëvizjes.



4. Regjistrat përfshijnë masat e zbatuara, përfshirë heqjen e kateve shtesë, operacionet e nxjerrjes së mjalitit si dhe sasinë dhe datën e nxjerrjes së mjalitit.

Neni 83

Mbajtja e të dhënave për përjashtimet

1. Operatorët mbajnë dokumentacionin për çdo përjashtim nga rregullat e prodhimit blegtoral, të miratuara në përputhje me pikat 2 dhe 4, të nenit 16, pikën 2, të nenit 27, pikën 11, të nenit 34, shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 54, pikës 1, të nenit 57, pikën 4, të nenit 58 dhe shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 59 të këtij udhëzimi.

2. Operatorët mbajnë regjistra ose dokumentacionin lidhur me origjinën e kafshëve, identifikimin e përshtatshëm, për kafshë ose grup, tufë ose koshere, të dhënat e trajtimit veterinar të kafshës që hyn në fermë, datën e mbërritjes dhe periudhën e kalimit.

Neni 84

Përjashtimet në raste të jashtëzakonshme

1. Në rastet e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 19 të ligjit, Komisioni për Prodhimin Organik miraton përjashtimet nga rregullat e prodhimit organik blegtoral në përputhje me pikën 5 të nenit 19 të ligjit.

KREU XVII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 85

Dispozita kalimtare

1. Rregullat përjashtimore të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikave 1, të neneve 54 dhe 59, të këtij udhëzimi, zbatohen deri më 31 dhjetor 2027.

2. Fermat ose njësitë prodhuese që mbarështojnë derra, të ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe për të cilat është e nevojshme një

investim i lartë, për të përmbushur kërkesën sipas pikës 1 të nenit 54, detyrohen të plotësojnë këtë kërkesë, jo më vonë se 1 janari 2030.

3. Fermat ose njësitë prodhuese me strehime me shumë kate për shpendët, të ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe për të cilat është i nevojshëm një investim i lartë për të përmbushur kërkesat e shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 61 të këtij udhëzimi, detyrohen të plotësojnë këto kërkesa, jo më vonë se 1 janari 2030.

4. Fermat ose njësitë prodhuese me kapanone për shpendët që kanë sipërfaqe të hapura për qasje të lirë të kafshëve përtej rrezes prej 150 metra nga hyrja/dalja më e afërt e strehimit të shpendëve, të ndërtuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe për të cilat është i nevojshëm një investim i lartë për të përmbushur kërkesën sipas pikës 6, të nenit 62 të këtij udhëzimi, detyrohen të plotësojnë këtë kërkesë, jo më vonë se 1 janari 2030.

5. Fermat ose njësitë prodhuese që rrisin zogj femra për prodhim vezësh të ndërtuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe për të cilat është i nevojshëm një investim i lartë për të përmbushur rregullat e përcaktuara në pjesën IV, të aneksit të këtij udhëzimi, detyrohen të plotësojnë këto kërkesa, jo më vonë se 1 janari 2030.

Neni 86

Dispozitat e fundit

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, trupat e kontrollit dhe autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar në fermë dhe të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 87

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më datë 29 tetor 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj



ANEKS

DENDËSIA E POPULLATËS SË KAFSHËVE DHE SIPËRFAQJA MINIMALE PËR ZONAT E BRENDSHME DHE TË JASHTME PËR KAFSHËT

Pjesa I: Dendësia e popullatës së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e brendshme dhe të jashtme për kafshët e llojit gjedhë, dele, dhi dhe kuaj është:

1. Kafshët e llojit gjedhë

	Zona e brendshme (sipërfaqja neto e disponueshme për kafshët)		Zona e jashtme (zona e ushtrimit, duke përfshirur kullotën)
	Pesha e gjallë (kg)	m ² /krerë	m ² /krerë
	Deri në 100	1,5	1,1
	Deri në 200	2,5	1,9
	Deri në 300	4,0	3,0
	Mbi 350	5 me minimumi 1m ² /100 kg	3,7 me minimumi 0,75m ² /100 kg
Lopë për qumësht		6	4,5
Dema për mbarështim		10	30

2. Kafshët e llojit dhen dhe dhi

	Zona e brendshme (sipërfaqja neto e disponueshme për kafshë) në m ² /krerë	Zona e jashtme (zona e ushtrimit, duke përfshirur kullotën) në m ² /krerë
Dele	1,50	2,50
Qingj	0,35	0,50
Dhi	1,50	2,50
Kec	0,35	0,50

3. Kafshët e llojit njëthundrakë

	Zona e brendshme (sipërfaqja neto e disponueshme për kafshët)		Zona e jashtme (zona e ushtrimit, duke përfshirur kullotën)
	Pesha e gjallë (kg)	m ² /krerë (përmasa e kutive sipas lartësisë së kuajve)	m ² /krerë
Kafshët e llojit kuaj për mbarështim dhe majmëri	Deri në 100	1,5	1,1
Për të gjithë llojet	Deri në 200	2,5	1,9
	Deri në 300	4,0	3,0
	Mbi 350	5 me minimumi 1m ² /100 kg	3,7 me minimumi 0,75 m ² /100 kg

Pjesa II: Dendësia e mbajtjes së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e jashtme për kafshët e llojit drerë

Llojet e kafshëve drerë	Sipërfaqja minimale për zonat e jashtme për rrethim ose për stallë	Dendësia e popullatës së kafshëve/numri maksimal i kafshëve të rritura* për hektar
Dreri sika <i>Cervus nippon</i>	1 ha	15
Dreri i luginës <i>Dama dama</i>	1 ha	15
Dreri i kuq <i>Cervus elaphus</i>	2 ha	7
Dreri Përe David <i>Elaphurus davidianus</i>	2 ha	7
Më shumë sesa një lloj dreri	3 ha	7 në rast se dreri i kuq ose dreri Përe David janë pjesë e tufës 15 në rast se as dreri i kuq dhe as dreri Përe David nuk janë pjesë e tufës

*Dy drerë deri në 18 muajsh konsiderohen si një dre i rritur.



Pjesa III: Dendësia e mbajtjes së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e brendshme dhe zonat e jashtme për kafshët e llojit derra

Llojet e kafshëve derra	Zona e brendshme (sipërfaqja neto e shfrytëzueshme për kafshët e llojit derra që përfshin sipërfaqen e brendshme, përfshirë vendet që përdoren për mbajtjen e ushqimit për kafshë, pa përfshirë pajisjet që përdoren për ushqyerjen, në të cilat derrat nuk mund të shtrihen)		Zona e jashtme
	Pesha e gjallë minimale (kg)	m ² /krerë	m ² /krerë
Dosat që kanë lindur, me gicat deri në përfundimin e ushqyerjes me gjë dhe ndarjes nga nëna		7,5 për dosë	2,5
Kafshët e llojit derra për majmëri Gicat pasi largohen nga nëna, derrat e rinj në rritje, paradosat që nuk kanë pjellë asnjëherë, derrat e rinj meshkuj që janë duke u rritur për t'u përdorur për riprodhim	Jo më shumë se 35 kg	0,6	0,4
	Më shumë se 35 kg, por jo më shumë se 50 kg	0,8	0,6
	Më shumë se 50 kg, por jo më shumë se 85 kg	1,1	0,8
	Më shumë se 85 kg, por jo më shumë se 110 kg	1,3	1,0
	Më shumë se 110 kg	1,5	1,2
Dosat për mbarështim Dosat shtatzënë që nuk kanë lindur ende		2,5	1,9
Derra meshkuj për mbarështim Derra meshkuj të rritur dhe që përdoret për riprodhim		6 10 nëse vendqëndrimet përdoren për shërbim natyror	8

Pjesa IV: Dendësia e mbajtjes së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e brendshme dhe të jashtme për shpendët

1. Pulat prind të llojit *Gallus gallus* për prodhimin e vezëve për çelje, që më pas do të jenë pula për vezë dhe pulat prind të llojit *Gallus gallus* për prodhimin e vezëve për çelje, që më pas do të jenë pulat e ardhshme *Gallus gallus* për majmëri:

Mosha	≥ 18 javë
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e brendshme	
Numri maksimal i shpendëve për mbarështim për m ² sipërfaqe të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të strehimit	6
shkallare/strukturat për qëndrimin e shpendëve për mbarështim që do përdoren si pula për vezë në të ardhmen. Minimum cm/zog pule	18
Furrik	7 zogj femra për furrik ose në rastin e furrikut të përbashkët 120 cm ² /zog femër
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për zog në zonat e jashtme	4

2. Zogjtë e pulës dhe gjelat

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² e zonës së brendshme të shfrytëzueshme të strehimit	21 kg peshë e gjallë/m ²
shkallare/strukturat për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja	Çdo kombinim i strukturës ose niveleve të vendqëndrimeve të ngritura ose të dyja, duke mundësuar minimumi 10 cm strukturë/zog ose minimumi 100 cm ² vendqëndrim të ngritur /zog
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	1



3. Pulat për vezë, duke përfshirë linjat e shpendëve me qëllim të dyfishtë, të rritura për prodhimin e mishit dhe vezëve:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Numri maksimal i zogjve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të strehimit	6
Strukturat	18
Minimumi cm strukturë/zog	
Furrik	7 pula për vezë për furrik ose në rastin e furrikut së përbashkët 120 cm ² /pulë për vezë
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	4

4. Shpendët për majmëri të llojit *Gallus gallus*:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të kotecit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Shkallare/strukturat për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele të zogjve ose të kombinuara të dyja	Çdo kombinim i strukturave për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja, duke mundësuar minimumi 5 cm strukturë/zog ose minimumi 25 cm ² vend qëndrimi të ngritur/zog
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme për strehimet e palëvizshme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	4
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme për strehimet e lëvizshme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	2,5

5. Shpendët për majmëri të llojit *Gallus gallus*: gjelat e kastruar dhe pulat e majmura:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të strehimit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Shkallare/strukturat për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele të zogjve ose të dyja	Çdo kombinim i strukturave për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja, duke mundësuar minimumi 5 cm strukturë/zog ose minimumi 25 cm ² vend qëndrimi i ngritur/zog
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për shpend në zonën e jashtme	4

6. Shpendë për majmëri përveç llojit *Gallus gallus*: gjelat e detit/pulat e detit *Meleagris gallopavo*, të tregtuar të plotë për pjekje ose për t'u copëtuar:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të kotecit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Strukturat për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja	Çdo kombinim i strukturave për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja, duke mundësuar minimumi 10 cm strukturë/zog ose minimumi 100 cm ² vendqëndrimi të ngritur/zog
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për shpend në zonën e jashtme	10

7. Shpendë për majmëri përveç llojit *Gallus gallus*: pata *Anser anser domesticus*:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të kotecit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	15

8. Shpendë për majmëri përveç *Gallus gallus*: rosat e racës pekineze *Anas platyrhynchos domesticus*, rosat Muscovy *Cairina moschata* dhe hibridët dhe rosat e egra *Cairina moschata* × *Anas platyrhynchos*:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të kotecit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për zog në zonën e jashtme	4,5

9. Shpendët për majmëri përveç llojit *Gallus gallus*: dhenjë Guinea *Numida meleagris f. domestica*:

Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e brendshme	
Dendësia e mbajtjes së shpendëve për m ² sipërfaqeje të shfrytëzueshme të zonës së brendshme të kotecit	21 kg peshë e gjallë/m ²
Strukturat për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja	Çdo kombinim i strukturave për qëndrimin e shpendëve në një ose disa nivele ose të dyja, duke mundur minimumi 5 cm strukturë/zog ose minimumi 25 cm ² vend qëndrimi i ngritur/zog
Dendësia e mbajtjes së shpendëve dhe sipërfaqja minimale për zonën e jashtme	
Minimumi m ² për shpend në zonën e jashtme	4

Pjesa V: Dendësia e mbajtjes së kafshëve dhe sipërfaqja minimale për zonat e brendshme dhe të jashtme për lepujt.

1. Për zonën e brendshme

	Zona e brendshme (sipërfaqja neto e shfrytëzueshme për kafshë, duke përjashtuar platformat, m ² /krerë) për hapësirën e pushimit	
	Strehat e palëvizshme	Strehat e lëvizshme
Lepuj femra me të vegjël deri në shkëputjen nga gjiri	0,6 m ² /lepur femër me të vegjlit nëse pesha e gjallë e lepurit femër është nën 6 kg 0,72 m ² /lepur femër me të vegjlit nëse pesha e gjallë e lepurit femër është mbi 6 kg	0,6 m ² / lepur femër me të vegjlit nëse pesha e gjallë e lepurit femër është nën 6 kg 0,72 m ² / lepur femër me të vegjlit nëse pesha e gjallë e lepurit femër është mbi 6 kg
Lepujt femra shtatzënë dhe lepujt femra riprodhuese	0,5 m ² /lepur femër shtatzënë ose riprodhuese nëse pesha e gjallë është nën 6 kg 0,62 m ² /lepur femër shtatzënë ose riprodhuese nëse pesha e gjallë është mbi 6 kg	0,5 m ² /lepur femër shtatzënë ose riprodhuese nëse pesha e gjallë është nën 6 kg 0,62 m ² /lepur femër shtatzënë ose riprodhuese nëse pesha e gjallë është mbi 6 kg
Lepujt për majmëri nga faza e shkëputjes nga ushqyerja me gjë deri tek therja Lepujt zëvendësues (përfundimi i majmërisë deri në 6 muaj)	0,2	0,15
Lepujt meshkuj të rritur	0,6; 1 nëse lepur mashkull merr lepur femër për çiftëzim	0,6 ; 1 nëse lepur mashkull merr lepur femër për çiftëzim

2. Për zonën e jashtme

	Zona e jashtme/hapësirë me bimësi, mundësisht kullotë, në zonën e jashtme (sipërfaqja neto e shfrytëzueshme për kafshë, duke përjashtuar platformat m ² /krerë)	Zona e jashtme (sipërfaqja neto e shfrytëzueshme për kafshë, duke përjashtuar platformat m ² /krerë)
	Strehim i palëvizshëm	Strehim i lëvizshëm
Lepuj femra me të vegjlit deri në shkëputjen nga gjiri	2,5 m ² /lepur femër me të vegjël	2,5 m ² / lepur femër me të vegjël
Lepuj femra shtatzënë /riprodhuese	2,5	2,5
Lepujt për majmëri nga faza e shkëputjes nga gjiri deri tek therja Lepujt zëvendësues (përfundimi i majmërisë deri në 6 muaj)	0,5	0,4
Lepuj meshkuj të rritur	2,5	2,5



URDHËR
Nr. 4, datë 13.6.2025

**PËR SHPALLJEN E “THIRRJES SË
DHJETË” NË KUADËR TË PROGRAMIT
KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË
PUNËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 14/2, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë” të ndryshuar, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 4.6.2025, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e “Thirrjes së dhjetë” të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në institucionet e administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, në institucionet e tjera publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, më datë 27.6.2025.

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, për vitin 2025, të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së thirrjes vjetore, që është pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 4.6.2025.

3. Ngarkohet grupi i punës, i ngritur për realizimin e “Thirrjes së dhjetë” të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHTETIT PËR RININË
DHE FËMIJËT**
Bora Muzhaqi

URDHËR
Nr. 580, datë 10.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
GREQISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465,

datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi nga i gjithë shteti i Greqisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 532, datë 28.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Anila Denaj



URDHËR

Nr. 581, datë 10.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Florina	Florina*	
Thessaloniki	Volvi*	
Xanthi	Xanthi*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;



b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në

një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët që plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe



janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 550, datë 30.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 582, datë 10.6.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E LETONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqura në shtetin e Letonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Vidzemes	Ogres	Birzgales*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.



5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 584, datë 11.6.2025

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË
VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Rrethi	Njësia administrative	Fshati
3 km			
1	Skrapar	Qendër Skrapar	Veseshite
2	Skrapar	Qendër Skrapar	Osoj
3	Skrapar	Qendër Skrapar	Polen
4	Skrapar	Qendër Skrapar	Qafë
5	Skrapar	Qendër Skrapar	Zogas
6	Skrapar	Qendër Skrapar	Kalanjes
7	Skrapar	Potom	Visockë
8	Skrapar	Qendër Skrapar	Dhores
10 km			
9	Skrapar	Leshnje	Gostençkë
10	Skrapar	Leshnje	Turbohovë
11	Skrapar	Leshnje	Kapinovë
12	Skrapar	Leshnje	Leshnje
13	Skrapar	Leshnje	Bersak
14	Skrapar	Leshnje	Krastë
15	Skrapar	Leshnje	Vlushë
16	Skrapar	Potom	Potom
17	Skrapar	Potom	Gorcellari
18	Skrapar	Potom	Helmes
19	Skrapar	Potom	Gjergjovë
20	Skrapar	Potom	Germenj
21	Skrapar	Potom	Koprençkë
22	Skrapar	Cepan	Dosti
23	Skrapar	Potom	Dymish
24	Skrapar	Cepan	Stërnec
25	Skrapar	Cepan	Muzhnok
26	Skrapar	Cepan	Zaberzan i Ri
27	Skrapar	Cepan	Zaberzan
28	Skrapar	Cepan	Bleznçkë
29	Skrapar	Cepan	Cepan
30	Skrapar	Cepan	Muzakë
31	Skrapar	Cepan	Prishtë
32	Skrapar	Qendër Skrapar	Grepçkë
33	Skrapar	Qendër Skrapar	Rehovic
34	Skrapar	Qendër Skrapar	Liqeth
35	Skrapar	Qendër Skrapar	Germisht
36	Skrapar	Qendër Skrapar	Slatinje
37	Skrapar	Qendër Skrapar	Nishicë
38	Skrapar	Qendër Skrapar	Cerovë
39	Skrapar	Qendër Skrapar	Veleshnje
40	Skrapar	Qendër Skrapar	Sharovë
41	Skrapar	Çorovodë	Çorovodë
42	Skrapar	Qendër Skrapar	Munushitir
43	Skrapar	Qendër Skrapar	Orizaj
44	Skrapar	Qendër Skrapar	Verzhez
45	Skrapar	Qendër Skrapar	Mollas
46	Skrapar	Qendër Skrapar	Radesh
47	Skrapar	Qendër Skrapar	Korritë

8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



VENDIM
Nr. 126, datë 12.6.2025

AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE “GRANTE PËR TË
RINJTË NË MBËSHTETJE TË
ZHVILLIMIT TË INICIATIVAVE
EKONOMIKE LOKALE”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Blendi Gonxhja kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 12.6.2025, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Bashkia Durrës mbi mbështetjen me grante nga buxheti i Bashkisë Durrës për të rinjtë e moshës 18–30 vjeç krijimin e mundësive për zhvillimin e ideve të biznesit të vogël dhe të mesëm.

I. Procedura

1. Bashkia Durrës, me shkresën nr. 1975, datë 7.2.2025, ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të incentivave ekonomike lokale”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*. Mbështetja e planeve të qëndrueshme të biznesit të krijuara nga të rinjtë e qytetit të Durrësit për krijimin ose zgjerimin e aktivitetit të bizneseve ekzistuese.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*. Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025–2027”.

4. *Kobëzgjatja*. Skema e ndihmës do të zbatohet në periudhën 2025–2027.

5. *Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës*. Bashkia Durrës.

6. *Përfituesit*. Përfitues janë të gjithë të rinjtë të cilët pas procesit të aplikimit janë fitues dhe do të mbështeten bazuar në idetë më të mira, inovative, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. e NMVM-të, duke iu nënshtruar një procesi të ndarë në tri faza:

7. *Shtirja sektoriale dhe territoriale*. Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Durrës.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës*. Buxheti i skemës në formën e grantit është 4,000,000 lekë. Përfitues të skemës do të jenë deri në 10 të rinj sipërmarrës.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, neni 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë,² përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit

² Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës Faqe | 15014

së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.



Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plani i ndihmës i miratuar në buxhetin e Bashkisë Durrës financohet nga buxheti i miratuar për Bashkinë Durrës nëpërmjet instrumentit të grantit për të rinjtë me ide biznesi në një vlerë të caktuar nga dhënësi i ndihmës. Nëpërmjet transferimit të burimeve shtetërore në formën e grantit të drejtpërdrejtë, Bashkia Durrës i ofron të rinjve sipërmarrës/përfituesve një avantazh, duke i lehtësuar mbi mbulimin e shpenzimeve që normalisht do të duhet të përballonin me fonde të veta përgjatë aktivitetit ekonomik. Ndhimja jepet vetëm për të rinjtë që do të jenë fitues nga procesi i përzgjedhjes së aplikantëve me idetë më të mira dhe garantojnë qëndrueshmërinë e biznesit. Skema ka potencialin të mbulojë pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë në territorin e Bashkisë Durrës, përfshirë ndërmarrjet që janë aktive në tregtinë rajonale/ndërkombëtare me ndikim në shtrebmërimin ose kërcënimin për të shtrebmëruar konkurrencën.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, i cili parashikon:

“Ndhimja “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis”, vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

1. Ndhimja lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Në kreun III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”, të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: “1 .Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”.

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe VKM-n nr. 605/2016, ndihma “De minimis” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet duke qenë se buxheti vjetor i skemës është 4, 000, 000 lekë.

b) Ndhimja duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Kohëzgjatja e skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është gjithsej tre vite, duke plotësuar këtë kusht ligjor. c) ndihma është transparente. Ky kusht plotësohet sepse ndihma jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm, në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit “Grante për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale”, të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025, dhe programin buxhetor afatmesëm 2025–2027”.



2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “*De minimis*” dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Bashkisë Durrës. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje nuk duhet të kalojë 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Bashkia Durrës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Blendi Gonxhja

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

KËRKESË

Nr. 225/9, datë 13.6.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion i bllokut të kufizuar nga rrugët ‘Ali Baushi’, ‘Arben Minga’, ‘Kongresi i Manastirit’, ‘Ibrahim Brahja’, ‘Xhanfize Keko’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tiranë

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake shpronësimi, 101,895,473.16 lekë (njëqind e një milion e tetëqind

e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “trual”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 101,895,473.16 lekë (njëqind e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kastriot Gurra

Page | 15017

Page | 15018

[illegible]

**KËRKESË****Nr. 457/10, datë 12.6.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ajencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit ‘Leje rikonstruksioni e ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi, për projektin ‘Përforcimi i pallatit 1300’”, Bashkia Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe llojit “ndërtesë”, bazuar VKM-në nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të

përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, i ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Kastriot Gurra**

LISTA EMËRORE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘LEJE RIKONSTRUKSIONI E NDRËTESËS SË DËMTUAR, PA SHTIM APO NDRYSHIM VOLUMI, PËR PROJEKTIN ‘PËRFORCIMI I PALLATIT 1300’”, BASHKIA VLORË

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m ²	Ndërtesë m ²	Adresa	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime	
1	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/1	truall	72	197	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00					Ndërtesa është njësi shërbimi dhe vlera është llogaritur me situacion punimesh. Objekti është i pandarë në fakt, ndaj është përlllogaritur një situacion për të gjithë ndërtesën.	
			19/237/2	truall	72	198	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00			4,843,852.00	5,533,752.00		
	Totali											689,900.00				4,843,852.00	5,533,752.00	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 176 lekë